



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 2

Tiranë – E martë, 15 janar 2019

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 11045, datë 10.1.2019	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 37
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 3, datë 9.1.2019	Për miratimin e planit të shpenzimeve, për vitin 2019, të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU)..... 37
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 4, datë 9.1.2019	Për miratimin e kuadrit makroekonomik dhe fiskal për periudhën 2020–2022..... 37
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 6, datë 9.1.2019	Për shpronësimin, marrjen në përdorim të përkohshëm dhe vendosjen e servitutit të kalimit për pasuritë e paluajtshme që preken nga projekti “Ndërtimi i pritave të cilat pengojnë vërshimin e lumenjve dhe sigurojnë mbrojtjen e tubacionit, pjesë e projektit të Gazsjellësit Trans Adriatic Pipeline (projekti TAP)”, në zonat Berat, Skrapar dhe Fier..... 49
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 7, datë 9.1.2019	Për dhënien e bursave për nxënësit e shkollës së mesme profesionale “Peter Mahringer”, Shkodër, për vitin shkollor 2018–2019..... 55
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 8, datë 9.1.2019	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 787, datë 22.9.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përbërjen e komisioneve eprore të caktimit të aftësisë për punë”, të ndryshuar..... 55
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 10, datë 9.1.2019	Për miratimin e rregullave për prodhimin, importin, eksportin, hedhjen në treg dhe përdorimin e substancave ozonholluese, si dhe për importin, eksportin, hedhjen në treg dhe përdorimin e produkteve e të pajisjeve që përmbajnë këto substanca..... 56
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 11, datë 9.1.2019	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2019 për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare..... 72
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 13, datë 14.1.2019	Për lirimin dhe emërimin në detyrë të prefektit të qarkut të Elbasanit..... 72

**DEKRET****Nr. 11045, datë 10.1.2019****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, të neneve 20, 24 dhe 14, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar në propozimet e Ministrisë së Brendshme

DEKRETOJ:**Neni 1**

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Denzel Agron Koçi
2. Myrvete Ali Selimi (Agalli)
3. Gazmor Sazan Kelmendi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË**
Ilir Meta

VENDIM**Nr. 3, datë 9.1.2019**

**PËR MIRATIMIN E PLANIT TË
SHPENZIMEVE, PËR VITIN 2019, TË
ENTIT RREGULLATOR TË SEKTORIT
TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE
TË NDOTURA (ERRU)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 11, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e planit të shpenzimeve, për vitin 2019, të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura, në shumën 45 394 000 (dyzet e pesë milionë e treqind e nëntëdhjetë e katër mijë) lekë, sipas pasqyrës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

ENTI RREGULLATOR I UJIT (ERRU)

Pasqyra nr. 1/1

PLANI I SHPENZIMEVE PËR VITIN 2019

Nr.	Emërtimi i shpenzimeve	Viti 2019 (lekë)
1.	Pagat dhe shtesat e tjera	28,035,000
2.	Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	4,397,000
3.	Shërbime e furniturë	11,882,000
4.	Investime	1,080,000
	TOTALI	45,394,000

VENDIM**Nr. 4, datë 9.1.2019**

**PËR MIRATIMIN E KUADRIT
MAKROEKONOMIK DHE FISKAL
PËR PERIUDHËN 2020–2022**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 23 e 27, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kuadrit makroekonomik dhe fiskal për periudhën 2020–2022, së bashku me lidhjet nr. 1 “Treguesit kryesorë makroekonomikë” dhe nr. 2/1 e nr. 2/2 “Treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar”, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



KUADRI MAKROEKONOMIK DHE FISKAL 2020–2022
Janar, 2019

Shkurtime

BB	Banka Botërore
BSH	Banka e Shqipërisë
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
INSTAT	Instituti i Statistikave
KM	Këshilli i Ministrave
KMF	Kuadri Makroekonomik dhe Fiskal
LOB	Ligji organik i buxhetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
SPI	Sistemi i Planifikimit të Integruar
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
WEO	World Economic Outlook

KUADRI MAKROEKONOMIK DHE
FISKAL 2020–2022

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Hyrje

Kuadri Makroekonomik e Fiskal (KMF) për periudhën 2020–2022 është pjesë e Sistemit të Planifikimit të Integruar dhe përgatitet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. KMF ka për qëllim përcaktimin e përparësive strategjike të qeverisë. Ai projekton pritshmërinë makroekonomike në horizontin kohor afatmesëm, si dhe parashikon nivelin e zërave të agreguar të të ardhurave dhe shpenzimeve të buxhetit të shtetit. Ai përcakton synimet dhe objektivat e qeverisë në lidhje me treguesit kryesorë të politikës fiskale si, balancën e përgjithshme fiskale (deficitin), huamarrjen, borxhin publik, balancën fiskale primare dhe atë korrente. KMF-ja shërben si bazë për përcaktimin e taveve në fazën e parë të procesit të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2020–2022 në nivel ministrie.

KMF-ja miratohet nga Këshilli i Ministrave në muajin janar të çdo viti, dhe mund të jetë sërish subjekt rishikimi dhe përditësimi përgjatë vitit, përpara finalizimit të PBA dhe të taveve për shpenzimet.


KMF-ja përmban dy komponentë kryesorë: i) parashikimet për treguesit kryesorë makroekonomikë të cilët paraqesin pritshmërinë ekonomike për vitin aktual dhe tri vitet e ardhshme; dhe ii) parashikimet dhe objektivat

për treguesit fiskalë, të cilët paraqesin burimet e pritshme në dispozicion të qeverisë për vitet 2020–2022 dhe shpërndarjen e tyre për këtë periudhë sipas buxhetit të konsoliduar. Këto komponentë paraqiten në mënyrë tabelore në fund të këtij dokumenti, përkatësisht lidhja nr. 1, lidhja nr. 2/1 dhe lidhja nr. 2/2.

1. Zhvillimet më të fundit makroekonomike

Ritmi i rritjes ekonomike ka vijuar të përshpejtohet edhe përgjatë periudhës kumulative nëntë mujore të vitit 2018. Pas rritjes prej 3.84% në vitin 2017, PBB-ja reale u rrit me 4.35% përgjatë nëntë muajve të vitit 2018, bazuar në vlerësimet tremujore të INSTAT-it, ndërkohë që vetëm për tremujorin e tretë të vitit 2018 ritmi i rritjes rezultoi më lart se sa dy tremujorët e mëparshëm, në rreth 4.48%.

Sipas optikës së kërkesës agregate, rritja përgjatë nëntë muajve të vitit 2018 u gjenerua si nga kërkesa e brendshme ashtu edhe nga ajo e huaj. Ndërsa për tremujorin e tretë kërkesa e brendshme vlerësohet se duhet të jetë nxitur kryesisht nga kontributi i konsumit, ndërkohë që, performanca e lartë e eksporteve të të mirave dhe shërbimeve (krahasuar me vitin e kaluar) vlerësohet të ketë qenë kontribuesi kryesor i rritjes për nga kërkesa e jashtme. Duke marrë në konsideratë performancën e nëntë muajve të vitit 2018 dhe pritshmëritë për tremujorin e katërt 2018, rritja ekonomike për të gjithë vitin 2018 pritët të jetë në linjë me parashikimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE) prej 4.2%.



Konsumi final total, i cili përbën peshën më të madhe në ekonomi, u rrit me rreth 2.83% në terma realë vjetorë përgjatë nëntë muajve të parë të 2018-s, ndërsa konsumi final i popullatës u rrit me rreth 3.41%. Ndërkohë vetëm për tremujorin e tretë konsumi final total dhe ai i popullatës shënuan përsheptim të ritmit krahasuar me dy tremujorët e parë respektivisht në 2.97% dhe 3.86%.

Formimi i kapitalit fiks bruto (investimet totale) u rrit me rreth 3.89% në terma realë vjetorë përgjatë nëntë muajve të vitit 2018, ndërkohë vetëm për tremujorin e tretë të vitit 2018 norma e rritjes për investimet u zgjerua në 5.40%.

Referuar statistikave të llogarive kombëtare tremujore të INSTAT, përgjatë nëntë muajve të vitit 2018, eksportet e mallrave dhe shërbimeve kanë kontribuar pozitivisht, ashtu siç ishte parashikuar. Gjithsesi, kontributi pozitiv i eksporteve është kundër peshuar nga efekti negativ i importeve si rrjedhojë e rritjes dhe peshës specifike të lartë të këtyre të fundit, duke bërë që kërkesa e huaj neto në total të ketë një efekt negativ në rritjen reale ekonomike të nëntë muajve të 2018-s.

Sipas perspektivës së ofertës agregate, rritja e PBB-së prej 4.35% përgjatë nëntë muajve të vitit 2018 u gjenerua në një masë të konsiderueshme nga vazhdimi i performancës pozitive të sektorit të industrisë. Ky sektor regjistroi një rritje reale vjetore prej rreth 18.9% përgjatë nëntë muajve të vitit 2018, duke dhënë kontributin më të lartë në rritjen e PBB-së prej rreth 2.37 pikë përqindje, në linjë me dinamikën e investimeve totale. Gjithashtu, dhe në terma diskretë për tremujorin

e tretë, ritmi i rritjes së industrisë rezultoi në rreth 15.4% në terma vjetorë.

Të tjerë sektorë të ofertës agregate që dhanë një kontribut të qenësishëm pozitiv në rritjen ekonomike përgjatë nëntë muajve të vitit 2018 ishin: i) Aktivitete shkencore, profesionale dhe teknike me një rritje reale vjetore prej rreth 7.27% dhe një kontribut prej 0.3 pikë përqindje; ii) Shitje me shumicë dhe me pakicë etj., me një rritje vjetore prej rreth 5.1% dhe një kontribut prej 0.78 pikë përqindje; iii) Arte, argëtim dhe çlodhje me një rritje vjetore prej rreth 4.48% dhe një kontribut prej 0.1 pikë përqindje; iv) Ndërtimi me një rritje reale vjetore prej rreth 2.1% dhe një kontribut prej 0.19 pikë përqindje.

Në linjë me përsheptimin e aktivitetit ekonomik ka rezultuar edhe dinamika e tregut të punës. Referuar anketës tremujore të forcës së punës nga INSTAT-i, punësimi deri në tremujorin e tretë të vitit 2018 u rrit me 1.9% krahasuar me të njëjtin tremujor të një viti më parë, ose me rreth 21.5 mijë të punësuar. Norma e papunësisë (për grup-moshën 15–64 vjeç) ka vijuar trendin e saj rënës që prej T1-2014 ku regjistroi vlerën e saj më të lartë prej 18%, duke zbritur tashmë në nivelin 12.7% në T3-2018, me një reduktim prej 1.3 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë (T3-2017), ose me një reduktim të numrit të personave të papunë prej rreth 17.2 mijë në harkun kohor të një viti. Ndërkohë, për grup-moshën 15 vjeç e sipër, norma e papunësisë gjatë tremujorit të tretë të vitit 2018 regjistroi nivelin prej 12.2%.

Bazuar në statistikën e bilancit të pagesave të BSH-së, bilanci i pagesave (BP) për periudhën janar-shtator të vitit 2018, shënoi përmirësim kundrejt të njëjtës periudhë të një viti më parë duke arritur vlerën +97.6 milionë euro, nga -30.1 milionë euro më 2017-n. Ndërsa vetëm për tremujorin e tretë të 2018-s, BP regjistroi balancë pozitive prej 154.8 milionë euro, krahasuar me tremujorin e tretë të 2017-s ku shënoi një balancë prej +37.5 milionë euro.

Deficiti tregtar u thellua lehtësisht gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2018 me rreth 0.3%, si rezultat i një rritje të volumit të importeve. Megjithatë, deficiti i llogarisë korrente u përmirësua me rreth 11%, teksa zgjerimi i lehtë i deficitit tregtar u mbulua kryesisht nga përmirësimi i eksporteve neto të shërbimeve, të



cilat regjistruan një rritje prej rreth 7.9%. Në gamën e eksporteve të shërbimeve, ato që ndikuan më së shumti ishin shërbimet e ndërlydhura kryesisht me aktivitetin e sektorit turistik, të cilat u rritën me rreth 12.1%, duke kontribuar konsiderueshëm në reduktimin e deficitit të llogarisë korrente. Po ashtu, remitancat u rritën me rreth 7.9%, megjithatë kontributi i tyre në përmirësimin e llogarisë korrente ishte disi më marxhinal duke qenë se pesha e tyre është zvogëluar ndjeshëm përgjatë viteve të fundit.

Llogaria financiare dhe kapitale u zgjerua në vlerën +659 milionë euro gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2018 krahasuar me +774.1 milionë euro që ishte në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Ndërsa vetëm për tremujorin e tretë të 2018-s, llogaria financiare dhe kapitale u zgjerua në +188.8 mln euro, krahasuar me +290.3 mln euro në tremujorin e tretë të 2017-s.


Inflacioni ka vijuar të ketë një trend rritës përgjatë tre tremujorëve të parë të vitit 2018, duke u rritur nga 1.9% në tremujorin e parë deri në 2.2% në tremujorin e dytë dhe të tretë. Inflacioni mesatar për periudhën janar–nëntor 2017 ishte 2.1%.

2. Politikat fiskale

Politika fiskale për periudhën afatmesme 2020–2022 do të jetë e orientuar qartësisht drejt konsolidimit fiskal ndërkohë që siguron një nivel optimal investimesh prej mesatarisht rreth 5 për qind të PBB-së. Konsolidimi fiskal dhe reduktimi i borxhit publik është thelbësor për uljen e risqeve makroekonomike, të cilat pengojnë rritjen ekonomike dhe shkaktojnë paqëndrueshmëri makroekonomike. Objektivat e politikës fiskale në KMF 2020–2022 janë në përputhje të plotë me parimet dhe rregullat fiskale të ligjit organik të buxhetit (shih kuadratin në faqen 8).

Ky kuadër fiskal synon një deficit fiskal të përgjithshëm prej 1.6 për qind të PBB-së për 2020, nga 1.9 për qind i programuar për vitin 2019; nivel prej 1.2 për qind të PBB-së më 2021; dhe 1.1 për qind në vitin 2022. Njëkohësisht targeton në vijimësi një balancë primare pozitive dhe në rritje për vitet 2020–2022, respektivisht

0.9 për qind më 2020 nga 0.5 për qind i targetuar në buxhetin 2019; 1.5 për qind më 2021; dhe 1.5 për qind në vitin 2022. Po ashtu edhe balanca korrente, pra diferenca midis investimeve publike dhe deficitit (huamarrjes) vjetore, targetohet në nivele të larta dhe në rritje graduale përgjatë horizontit afatmesëm. Respektivisht balanca korrente në vitin 2020 targetohet në nivelin 3.4 për qind të PBB, nga 3.3 për qind e targetuar për 2019-n; më tej targetohet në rritje në nivelin 3.7 për qind në vitin 2021 dhe 3.8 për qind në vitin 2022.



Ky konsolidim fiskal synon që niveli i borxhit publik si raport ndaj PBB-së të vijojë trajektoren e sigurt rënëse të nisur që në vitin 2016. Borxhi publik neto (i zhveshur nga gjendja e mjeteve likuide të qeverisë) pritet që të bjerë rreth nivelit 62.3 për qind të PBB-së më 2020-n, 59.5% në vitin 2021, në linjë me objektivin afatmesëm të shpallur më parë për uljen e borxhit poshtë nivelit 60% brenda vitit 2021, dhe më tej pritet të vijojë reduktimin në 57.3 për qind në vitin 2022.

Në të njëjtën kohë, ky kuadër fiskal akomodon politika buxhetore për të mbështetur rritjen ekonomike dhe për të kompensuar efektet shtrënguese të konsolidimit fiskal. Investimet publike në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme parashikohen të mbahen rreth 5 për qind të PBB-së, nivel i cili vlerësohet si optimal për të ushqyer kërkesën agregate në afat të shkurtër dhe për ta zhvendosur rritjen potenciale ekonomike në një nivel të më të lartë në afat të mesëm dhe të gjatë.



PARIMET DHE RREGULLAT FISKALE

Në përputhje të plotë me obligimet që rrjedhin prej ligjit organik të buxhetit (LOB) nr. 57/2016, KMF 2020–2022 materializon parimet dhe rregullat fiskale të mëposhtme:

1. Në çdo ligj vjetor të buxhetit, fillestar apo të rishikuar, si dhe në planifikimet e buxhetit afatmesëm, raporti i borxhit publik ndaj Produktit të Brendshëm Bruto do të planifikohet më i ulët se niveli i vlerësuar për vitin pararendës, deri atëherë kur niveli i borxhit të arrijë dhe qëndrojë poshtë nivelit 45 për qind të Produktit të Brendshëm Bruto.

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskal) të LOB, KMF 2020–2022 **targeton çdo vit një nivel të borxhit publik total në përqindje të PBB më të ulët se sa niveli i vitit pararendës.**

2. Vlera e Produktit të Brendshëm Bruto, nominale në lekë, e cila do të përdoret për llogaritjen e raportit të borxhit publik ndaj Produktit të Brendshëm Bruto për vitet buxhetore që planifikohen dhe për vitin pararendës, nuk mund të jetë më e lartë se vlera respektive e parashikuar ose vlerësuar në raportin “Perspektiva ekonomike botërore” (World Economic Outlook), të Fondit Monetar Ndërkombëtar, më i fundit i publikuar në kohën kur ligji vjetor i buxhetit dorëzohet për miratim në Kuvend. Kjo dokumentohet qartësisht në relacionin shoqëruar të ligjit vjetor të buxhetit.

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskal) të LOB, Kuadri 2020–2022 **bazohet në projeksionet e mëposhtme të PBB nominale, të cilat paraqiten në mënyrë krabasimore kundrejt projeksioneve të raportit “Perspektiva Ekonomike Botërore”** (World Economic Outlook), të Fondit Monetar Ndërkombëtar, më i fundit i publikuar në tetor 2018.

Parashikimet e PBB nominale të FMN dhe MFE

(në miliardë Lekë)

	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
			Para.	Para.	Para.	Para.	Para.
FMN - Perspektiva Ekonomike Botërore	1,475.3	1,553.0	1,653.5	1,754.4	1,869.3	2,001.5	2,142.8
MFE	1,475.3	1,552.9	1,647.6	1,752.7	1,869.2	2,000.3	2,118.7
Diferenca FMN - MFE							
(Diferenca duhet të jetë jo më e vogël se zero)	0	0.1	5.9	1.7	0.1	1.2	24.2

3. Në çdo vit buxhetor të planifikuar duhet të përfshihet një kontingjencë e veçantë, prej jo më pak se 0.7 për qind e shpenzimeve totale të buxhetit, për të kompensuar rreziqe potenciale nga luhatjet në kurset e këmbimit ose normat e interesit, me ndikim në nivelin e borxhit.

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskal) të LOB-së, Kuadri 2020–2022 përfshin për çdo vit në një zë të veçantë të tij, emërtuar “Kontigjencë për luhatjet e normave të interesit etj.” **një kontigjencë prej mbi 0.7 për qind e shpenzimeve totale.**

4. Të ardhurat nga privatizimi nuk janë pjesë e procesit të programimit buxhetor. Në rastet e arkëtimit ato përdoren, jo më pak se 50 për qind, për uljen e borxhit publik dhe pjesa tjetër për investime publike. Pas arritjes së nivelit të borxhit publik, sipas përcaktimeve të shkronjës “a”, të pikës 1, të nenit 4/1 të ligjit organik të buxhetit nr. 57/2016, përdorimi i të ardhurave të arkëtuara nga privatizimet përcaktohet në ligjin vjetor të buxhetit.

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskal) të LOB-së, Kuadri 2020–2022 **nuk përfshin të hyra nga privatizimet e mundshme.**

5. Masa e deficitit buxhetor nuk mund të tejkalojë masën e shpenzimeve kapitale të parashikuara çdo vit në ligjin e buxhetit.

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskal – “rregulli i artë”) të LOB, deficitin e targetuar në Kuadrin 2020–2022 **është çdo vit më i ulët sesa shpenzimet kapitale të planifikuara.** Rrjedhimisht, balanca korrente e targetuar është pozitive prej mesatarisht 3.6 për qind të PBB-së në çdo vit të programuar.

1. Linku për aksesimin e raportit WEO – <https://www.imf.org/en/Publications/WEO/Issues/2018/09/24/world-economic-outlook-october-2018>



3. Parashikimet e Treguesve Makro-ekonomikë dhe Fiskalë

Metodologjia e parashikimeve makro-ekonomike

Parashikimi i treguesve makroekonomikë afatmesëm dhe i tërësisë së elementeve përbërëse të kuadrit makroekonomik është bazuar kryesisht në metodat modeluese dhe analitike të programimit financiar. Skenari bazë i kuadrit makroekonomik, mbështetet në linjën aktuale të politikave makroekonomike, në linjën aktuale të politikave e reformave ekonomiko-strukture qeveritare, në sjelljen dhe në bashkëveprimin racional të agjentëve ekonomikë brenda kontureve të ambientit të brendshëm e të jashtëm makroekonomik, i cili vlerësohet si më i mundshmi për periudhën afatmesme në vijim. Në kryerjen e këtyre parashikimeve janë ngritur një set supozimesh bazë, si dhe janë përdorur një set i gjerë të dhënash statistikore makroekonomike të gjeneruara prej institucioneve, si: INSTAT, BSH, MFE, FMN, BB, Eurostat etj. Këto statistika janë kryesisht në formën e serive kohore me frekuencë vjetore, tremujore e mujore. Kohëzgjatja e tyre e marrë në konsideratë për ndërtimin e këtij kuadri është përgjithësisht që prej vitit 1996. Pasi janë ndjekur të gjitha etapat metodologjike të parashikimit, skenari bazë i përfutur synon të paraqesë situatën makroekonomike përgjithësisht më të mundshme dhe maksimalisht konsistente në aspektin e një ekonomie të plotë e integrale.

Objektivat themelorë të miksit të politikave fiskale e monetare përgjatë tri viteve në vijim nëpërmjet të cilave synohet ruajtja dhe konsolidimi i mëtejshëm i stabilitetit makroekonomik të vendit, krijimi i klimës për një rritje të lartë e të qëndrueshme ekonomike, si dhe konvergimi sa shpejt drejt nivelit mesatar të mirëqenies të Bashkimit Evropian, janë:

- Targetimi i një trajektore rënëse të borxhit publik duke synuar nivelin e borxhit publik neto poshtë 60 për qind të PBB-së në vitin 2021 dhe më tej rreth nivelit 57% në vitin 2022;

- Mbajtja e një niveli të investimeve publike mbi nivelin e deficitit të përgjithshëm fiskal në çdo vit dhe mundësisht afër nivelit optimal prej 5 për qind të PBB-së;

- Harmonizimi me objektivin themelor të politikës monetare për stabilitetin e çmimeve e cila

targeton një normë inflacioni në nivelin 3 për qind dhe ankorimin e pritshmërive të tij rreth këtij niveli;

- Zbutja e deficitit të llogarisë korrente dhe përmirësimi i pozicionit të jashtëm të ekonomisë duke tentuar rritjen graduale të nivelit të rezervave valutore, dhe duke ruajtur të paktën një nivel dysheme të tyre, të mjaftueshëm për të financuar jo më pak se 4 muaj import mallrash dhe shërbimesh.

Këta objektiva fundamentale përbëjnë konturet bazë të këtij programi ekonomik e fiskal brenda të cilave përcaktohen projeksionet dhe programohen të gjithë variablat e tjerë makroekonomikë e fiskalë.

Skenari makroekonomik e fiskal afatmesëm

Ekonomia pritet të vazhdojë trendin pozitiv në periudhën afatmesme. Rritja ekonomike parashikohet të vijojë të qëndrojë mbi nivelin prej 4% edhe gjatë tri viteve të tjera 2020–2022, madje duke vijuar ende një përshpejtim, megjithëse marxhinal, edhe gjatë këtyre viteve. Më konkretisht, rritja ekonomike parashikohet të jetë në nivelin prej 4.4% në vitin 2020 nga 4.2% e parashikuar për 2018-n dhe 4.3% për 2019-n. Edhe në dy vitet e tjera, 2021 dhe 2022, ajo parashikohet të vijojë të përshpejtohet marxhinalisht me rreth 0.1 pikë përqindje, respektivisht në 4.5% në vitin 2021 dhe më 2022.

Gjatë periudhës afatmesme rritja pritet të gjenerohet kryesisht nga kërkesa e brendshme, si konsumi privat ashtu edhe investimet. Ndërkohë kërkesa e huaj neto (eksport–import) pritet të sjellë, gjithashtu, një efekt pozitiv, por marxhinal. Konsumi privat pritet të nxitet kryesisht nga përmirësimi i besimit të konsumatorit, si dhe nga përmirësimet në tregun e punës. Këto të fundit pritet të transmetohen në një rritje graduale të pagave të cilat më tej pritet të stimulojnë të ardhurat reale të disponueshme të individëve, duke krijuar efektin e raundit të dytë në nxitjen e konsumit, si dhe duke intensifikuar prirjen e konsumatorëve për financimin e mëtejshëm të konsumit nëpërmjet një kredi-marrje më të lartë. Ndërkohë, kredimarrja për konsum parashikohet të nxitet si nga përmirësimi i kushteve financiare të individëve, ashtu edhe nga lehtësimi i pritshëm i standardeve të huadhënies nga sistemi bankar.

Ndërsa rritja graduale e investimeve pritet të nxitet nga shfrytëzimi më i intensifikuar i kapaciteteve ekzistuese të prodhimit i vërejtur së fundmi, si dhe nga përshpejtimi i aktivitetit ekonomik gjatë periudhës së parashikuar dhe



perceptimi i përmirësuar i biznesit mbi perspektivën ekonomike afatmesme e afatgjatë. Njëkohësisht edhe vijmësia e përmirësimit të kushteve financiare dhe lehtësimit të standarteve të huadhënies pritet të jetë një faktor i rëndësishëm incentivues i investimeve private në afatin e mesëm.



Specifikisht, konsumi final total për periudhën afatmesme (2020–2022) parashikohet të rritet në terma realë me mesatarisht rreth 3.1% në vit, duke kontribuar me mesatarisht rreth 2.8 pikë përqindje në vit në rritjen e PBB-së. Ndërsa investimet totale në ekonomi parashikohen të rriten në terma realë me mesatarisht rreth 5.9% në vit, me një përshtepje të lehtë në vitet 2021 dhe 2022, me një kontribut mesatar në rritjen totale prej rreth 1.5 pikë përqindje në vit.

Kërkesa e jashtme neto pritet të ketë efekte pozitive minimale në periudhën afatmesme. Eksportet e mallrave të cilat kanë pasur performancë mjaft të mirë gjatë vitit 2018, priten të vazhdojnë këtë trend pozitiv dhe të ruajnë ritmet e kaluara, duke supozuar se nuk do të ketë goditje të ndjeshme negative të çmimeve të naftës dhe

mineraleve në tregjet ndërkombëtare. Eksportet e shërbimeve, veçanërisht shërbimet turistike, priten, gjithashtu, të vijojnë performancën pozitive në periudhën afatmesme dhe do të jenë elementi kryesor për të kompensuar kontributin negativ të ardhur prej rritjes së importeve.

Sa i takon më specifikisht komponentëve të kërkesës së huaj neto, eksportet e mallrave dhe shërbimeve për periudhën 2020–2022 parashikohen të rriten me mesatarisht rreth 6.4% në vit në terma realë, me një kontribut mesatar pozitiv prej rreth 2.1 pikë përqindje në vit në rritjen e PBB-së. Ndërsa importet e mallrave dhe shërbimeve për këtë periudhë afatmesme parashikohen të zgjerohen me mesatarisht rreth 4.2% në vit me një kontribut mesatar negativ në rritjen e PBB-së me rreth -1.9 pikë përqindje në vit. Rrjedhimisht, në terma neto kërkesa e huaj parashikohet të ketë një kontribut lehtësisht pozitiv në rritjen totale të PBB-së, me mesatarisht rreth 0.2 pikë përqindje në vit.

Grafikë: Rritja reale (majtas, në %) dhe kontributet në rritje (djathtas, në p.p.) sipas komponentëve të kërkesës agregate





Burimi: INSTAT, MFE

Megjithëse politika fiskale do të vazhdojë të jetë e orientuar drejt konsolidimit në periudhën afatmesme dhe afatgjatë, politika buxhetore e qeverisë për të ruajtur një nivel të investimeve publike në rreth 5% të PBB-së në vitet 2020–2022 do të stimulojë formimin e kapitalit fiks bruto në ekonomi, esenciale kjo për të mbështetur nivele relativisht të larta rritje në periudhën afatmesme dhe afatgjatë. Në të njëjtën kohë, vijimi i politikës monetare akomoduese parashikuar në periudhën afatmesme, duke marrë parasysh presionet e ulëta inflacioniste, do të mbështesë konsumin privat dhe investimet.

Konsolidimi fiskal i synuar nga qeveria do të kufizojë kërkesën e përgjithshme të sektorit publik. Si i tillë, nuk pritet të jetë një nxitës i rritjes në periudhën afatmesme. Megjithatë, konsolidimi fiskal do të ulë primin e riskut në periudhën afatmesme dhe do të rrisë hapësirat për stimulimin e sektorin privat, fundamente mjaft të rëndësishme këto për sigurimin e një rritje të lartë e të qëndrueshme. Në të njëjtën kohë, komponentët e politikave buxhetore të planifikuara do të mbështesin rritjen dhe për këtë arsye efekti shtrëngues i konsolidimit fiskal pritet të kompensohet.



Grafik: Rritja reale (majtas, në %) dhe kontributet në rritje (djathtas, në p.p.) sipas komponentëve të ofertës agregate





Burimi: INSTAT, MFE

Nga pikëpamja e ofertës agregate pritet që të gjithë sektorët kryesorë të vazhdojnë të rriten pak a shumë me të njëjtin trend të mesatares së tyre historike. Specifikisht, bujqësia pritet të rritet mesatarisht me rreth 3.3% në vit në terma realë përgjatë periudhës 2020–2022; Industria me një mesatare vjetore prej rreth 6.2%; Ndërtimi me rreth 4.8% dhe shërbimet me një mesatare prej rreth 4.2% në vit. Megjithatë, për shkak të peshës së tyre ndaj strukturës së ofertës agregate, shërbimet pritet të kontribuojnë më shumë sesa sektorët e tjerë në rritjen e PBB-së.

Në përputhje me parashikimet afatmesme të rritjes, punësimi pritet të rritet me një mesatare

prej rreth 2.4% në vit gjatë viteve 2020–2022. Shkalla më e lartë e pjesëmarrjes në forcat e punës do të jetë gjeneruesi kryesor i rritjes së ofertës së punës. Ndërsa rritja e kërkesës për punë pritet të reflektojë pak a shumë të njëjtën strukturë të perspektivës së ofertës agregate të aktivitetit ekonomik. Rrjedhimisht pritet që shërbimet të kontribuojnë më shumë në rritjen e kërkesës për punë në krahasim me sektorët e tjerë të ekonomisë. Pavarësisht zgjerimit të pritshëm të punësimit në afatin e mesëm, sërish produktiviteti i përgjithshëm i punës pritet të ketë një përmirësim të lehtë gjatë kësaj periudhe.

Grafik: Punësimi (në të majtë, rritja vjetore në %) dhe norma e papunësisë (në të djathtë, në %)



Burimi: INSTAT, MFE

Presionet inflacioniste parashikohet të forcohen në periudhën afatmesme. Inflacioni pritet të rritet gradualisht dhe të rikthehet në objektivin e politikës monetare, brenda vitit 2020. Presionet e brendshme inflacioniste priten të përshpejtohen si rezultat i rritjes së konsumit privat dhe investimeve, të cilat do të mbështesin një ritëm më të shpejtë të

rritjes ekonomike. Për më tepër, parashikimi për forcimin e kërkesës agregate dhe inflacionit në mjedisin ndërkombëtar pritet të përçojë një efekt inflacionist disi më të rritur në ekonominë shqiptare për periudhën afatmesme në vijim.



Parashikimet për treguesit kryesorë makroekonomikë paraqiten në lidhjen nr. 1 bashkëngjitur VKM.



Bazuar mbi parashikimet e treguesve kryesorë makroekonomikë, reformave fiskale të ndërmarra, efekteve të pritshme të përmirësimit administrativ, si dhe të faktorëve të tjerë përcaktues në ecurinë e zërave të ndryshëm të të ardhurave të buxhetit të shtetit, të ardhurat totale të buxhetit për tri vitet në

vijim (2020–2022) parashikohet të rriten mesatarisht me rreth 6.5 për qind në çdo vit. Të ardhurat tatimore për këtë periudhë parashikohen me një rritje mesatare vjetore prej rreth 6.9 për qind.



Grafik: Të ardhurat (majtas në miliardë lekë, djathtas në për qind të PBB-së)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Duke qëndruar brenda kontureve të parashikimeve të treguesve makroekonomikë dhe të të ardhurave për tri vitet në vijim, si dhe duke synuar respektimin e objektivave të sipërpërmendur të deficitit fiskal për këtë periudhë, burimet totale të qeverisë për t'u shpenzuar gjatë viteve 2020–2022 pritet të jenë mesatarisht në rreth 554 miliardë lekë në çdo vit ose mesatarisht rreth 27.8 për qind e PBB-së. Investimet publike janë programuar të mbahen në një nivel mesatarisht prej rreth 5 për qind të PBB-së në çdo vit. Këto konsiderohen nivele optimale për mbështetjen e një rritje ekonomike të lartë e të qëndrueshme.

Grafik: Shpenzimet (majtas në miliardë lekë, djathtas në për qind të PBB-së)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Parashikimet e të ardhurave sipas zërave të buxhetit të konsoliduar, si dhe niveli i shpenzimeve të shpërndara sipas zërave të buxhetit të konsoliduar paraqiten në lidhjet nr. 2/1 dhe nr. 2/2 bashkëngjitur VKM, respektivisht në terma nominalë dhe në raport me PBB-në.



Lidhja nr. 1. Treguesit kryesorë makroekonomikë

Treguesit	Njësia	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
					Para.	Para.	Para.	Para.	Para.
Popullsia	Milion	2.9	2.9	2.9	2.9	2.9	2.9	2.9	2.9
Inflacioni (mesatar)	%	1.9	1.3	2.0	2.1	2.7	3.0	3.0	3.0
Deflatori i PBB	%	0.6	-0.5	1.4	1.9	2.0	2.2	2.5	1.4
Kursi i këmbimit (mesatar)	Lek / USD	126.0	124.1	119.1	108.0	108.0	108.0	108.0	108.0
Kursi i këmbimit (mesatar)	Lek / Euro	139.7	137.4	134.2	127.6	127.6	127.6	127.6	127.6
Faktori i Konvertimit sipas Paritetit të Fuqisë Blerëse (PPP)	Lek / USD	43.9	44.4	45.0	45.0	45.0	45.0	45.0	45.0
Rritja reale e PBB	%	2.2	3.4	3.8	4.2	4.3	4.4	4.5	4.5
PBB	Lek miliardë	1,434.3	1,475.3	1,552.9	1,647.6	1,752.7	1,869.2	2,000.3	2,118.7
PBB	USD miliardë	11.4	11.9	13.0	15.3	16.2	17.3	18.5	19.6
PBB	Euro miliard	10.3	10.7	11.6	12.9	13.7	14.7	15.7	16.6
PBB për banor	Lek një	497.9	512.9	540.4	573.3	609.9	650.3	695.9	737.0
PBB për banor	USD	3,952.8	4,131.7	4,537.5	5,309.3	5,647.4	6,022.1	6,443.9	6,824.5
PBB për banor	Euro	3,563.0	3,734.1	4,028.5	4,493.7	4,779.9	5,097.0	5,454.0	5,776.1
PBB për banor	USD-PPP	11,334.2	11,559.3	12,019.8	12,752.0	13,564.1	14,464.1	15,477.1	16,391.2
PBB për banor	Euro-PPP	10,638.9	10,258.7	10,333.0	10,962.5	11,660.7	12,434.3	13,305.2	14,091.0
Norma e papunësisë	%	17.5	15.6	14.1	12.8	11.7	10.7	9.8	9.4
Të ardhurat totale	% të PBB	26.4	27.6	27.7	28.0	27.8	27.8	27.8	27.8
Shpenzimet totale	% të PBB	30.5	29.4	29.7	30.0	29.6	29.3	28.9	28.8
Bilanci i përgjithshëm	% të PBB	-4.1	-1.8	-2.0	-2.0	-1.9	-1.6	-1.2	-1.1
Bilanci primar fiskal	% të PBB	-1.4	0.6	0.1	0.5	0.5	0.9	1.5	1.5
Bilanci korrent fiskal	% të PBB	0.4	2.6	3.0	3.2	3.3	3.4	3.7	3.8
Huamarrje totale neto	% të PBB	3.5	1.9	2.9	3.2	0.4	2.1	0.3	2.9
Borxhi publik NETO nga gjendja e likuiditetit në TSA (Neto)	% të PBB	71.9	71.6	68.7	66.6	64.6	62.3	59.5	57.3
Borxhi Publik (Bruto)	% të PBB	72.7	72.3	70.1	69.1	65.5	63.6	59.9	59.5
Borxhi publik i qeverisë së përgjithshme	% të PBB	68.8	68.6	66.8	66.2	62.6	60.7	57.1	56.8
Borxhi publik jashtë treguesve fiskale	% të PBB	4.0	3.7	3.3	3.0	2.9	2.9	2.8	2.7
Bilanci i llogarisë korrente	% të PBB	-8.6	-7.6	-7.5	-6.7	-6.3	-6.1	-6.0	-5.9
Bilanci tregtar (Mallra & Shërbime)	% të PBB	-17.3	-16.8	-15.1	-14.0	-13.4	-12.6	-12.1	-11.7
Mallra	% të PBB	-22.4	-24.2	-24.4	-22.6	-22.5	-22.1	-21.9	-21.6
Eksperte	% të PBB	7.5	6.6	6.9	7.5	7.7	7.9	8.1	8.3
Importe	% të PBB	-29.9	-30.9	-31.3	-30.1	-30.1	-30.0	-30.0	-29.9
Bilanci i pagesave	% të PBB	5.9	0.4	1.6	2.1	2.3	2.6	2.6	2.7
Rezervat valutore	Euro milion	2,880.0	2,945.0	2,995.9	3,270.9	3,583.4	3,968.8	4,379.5	4,826.1
Në muaj importi mallrash e shërbimesh	Muaj	7.6	7.2	6.7	6.7	6.9	7.2	7.5	7.8

Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Banka Botërore



Lidhja nr. 2/1. Treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar (në milionë lekë)

Nr.	EMËRTIMI	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
					A.N.2	Buxhet	PBA	PBA	PBA
	TOTALI TË ARDHURAVE	379,206	407,021	430,397	461,801	486,677	518,716	555,129	588,001
I.	Ndihmat	11,215	14,639	11,085	12,000	15,500	15,500	15,500	15,500
II.	Të ardhura tatimore	342,308	369,884	398,629	424,044	447,337	478,911	514,756	547,111
II.1	Nga tatimet dhe doganat	258,882	275,780	293,386	310,896	325,604	349,369	376,198	400,413
II.2	Të ardhura nga pushteti lokal	11,700	14,961	18,447	20,586	22,661	24,167	25,862	27,393
II.3	Të ardhura nga fondet speciale	71,726	79,153	86,796	92,562	99,071	105,375	112,696	119,305
III.	Të ardhura jo-tatimore	25,683	22,498	20,683	25,757	23,840	24,305	24,873	25,390
	TOTALI I SHPENZIMEVE	437,408	433,697	461,410	494,167	519,577	548,559	578,295	610,483
I.	Shpenzime Korrente	350,752	368,720	382,287	408,266	426,069	452,296	476,910	502,298
I.1	Personeli	72,489	67,540	72,642	75,908	80,753	82,473	84,973	89,473
	Paga	62,492	58,215	62,581	63,505	66,643	68,209	70,209	73,509
	Kontributi për sigurime shoqërore	9,997	9,325	10,061	10,803	11,110	11,764	12,264	12,464
	Fondi i veçantë i pagave				400	500	500	500	500
	Politika të reja pagash					2,000	1,000	1,000	2,000
	Arsimi i lartë nga të ardhurat e veta				1,200	1,500	1,000	1,000	1,000
I.2	Interesat	38,643	36,259	31,904	41,000	41,700	47,538	53,478	54,500
	Të brendshme	27,385	25,526	21,415	23,300	24,500	28,238	31,278	34,000
	Të huaja	11,258	10,733	10,489	13,700	12,900	12,300	13,700	14,000
	Kontingjent për luhatjet e normave të interesit, etj				4,000	4,300	7,000	8,500	8,500
I.3	Shpenzime operative e mirëmbajtje	42,409	44,329	43,441	45,938	46,852	50,741	53,348	55,798
	Të qeverges qendrore (operative & mirëmbajtje)				42,138	42,852	47,441	49,848	52,348
	Arsimi i lartë				1,800	1,900	1,000	1,200	1,100
	Të tjera jashtë limitit				2,000	2,100	2,300	2,300	2,350
I.4	Subvencionet	1,735	1,725	2,310	1,890	1,490	1,490	1,490	1,490
I.5	Shpenzime për fondet speciale	141,166	152,591	162,146	171,760	179,987	190,685	200,391	212,391
	Shumme shoqërore	107,309	114,276	119,081	122,515	130,637	138,965	145,965	154,465
	Politika të reja pensionesh				4,845	2,450	2,620	2,620	3,120
	Shumme dhëndësores	32,665	34,796	39,090	40,400	41,900	43,700	46,306	49,306
	Shpenzime për kompensimin në vlerë të pronarëve	1,162	3,519	3,974	4,000	5,000	5,000	5,500	5,500
I.6	Buxheti lokal	34,066	43,580	46,487	49,620	51,286	54,869	58,129	61,897
	Granti nga Buxheti i Shtetit për pushtetin vendor	22,366	28,629	28,039	24,034	25,075	26,032	27,467	29,054
	Fondi i pakushtezuar				16,580	17,632	18,600	20,000	21,187
	Granti Specifik				7,454	7,443	7,432	7,467	7,867
	Buxheti lokal (të ardhurat e veta tatimore)	11,700	14,961	18,447	20,586	22,661	24,167	25,862	27,393
	Taksa të ndara				600	650	670	700	750
	Buxheti lokal (të ardhurat e veta jo-tatimore)				3,100	2,900	3,000	3,100	3,200
	Financomi i huaj vendor dhe të tjera të mbartura				1,300		1,000	1,000	1,500
I.7	Transferat të tjera	20,244	22,696	23,357	22,150	24,000	24,500	25,100	26,750
	Pagosa e papunësisë	615	691	346	350	500	600	600	600
	Ndihma ekonomike	17,662	20,026	20,714	20,500	20,500	20,900	21,000	22,150
	Kompensim për të përfaqësuesit politikë	1,967	1,979	2,298	1,000	1,000	1,000	1,000	1,000
	Bonus i inojeve					2,000	2,000	2,500	3,000
II.	Fondi rezervë				1,500	2,900	3,500	4,100	5,400
	Fondi rezervë i Këshillit të Ministrave				1,500	1,500	1,500	1,500	2,600
	Rezervë për reformën në drejtësi					1,400	2,000	2,600	2,800
III.	Shpenzime kapitale	63,059	59,478	68,455	84,401	90,608	92,763	97,285	102,785
	Financomi i brendshëm	38,133	39,118	46,177	53,134	56,908	57,145	58,525	61,925
	Nga e dat. Fondi për infrastrukturën vendore dhe rajonale				8,000	5,000	4,000	3,500	3,500
	Arsimi i lartë nga të ardhurat e veta				700	1,100	1,200	1,200	1,300
	Financomi i huaj	24,926	20,360	22,278	30,567	32,600	34,418	37,560	39,560
	Nga të datat: energjia				5,500	3,000	4,500	5,000	5,000
IV.	Detyrimet e prapambetura	17,597							
V.	Të tjera	1,000	5,499	9,217					
VI.	Fond shpronësimit	5,000		1,450					
	DEFICITI	-58,202	-26,676	-31,012	-32,366	-32,900	-29,843	-23,165	-22,483
	FINANCIIMI DEFICITIT	58,202	26,676	31,012	32,366	32,900	29,843	23,165	22,483
I.	I brendshëm	-6,403	9,176	1,899	-230	48,697	14,314	39,665	-29,052
	Të ardhura nga privatizimi	877	2,805	418	50				
	Hua-marrje e brendshme (neto)	-17,268	10,602	16,285	19,947	22,900	22,900	22,900	9,900
	Të tjera, nga të datat:	9,988	-4,231	-14,804	-20,227	25,797	-8,586	16,765	-38,952
	Ndihmat i gjendjes së likuiditetit në TSA	-2,537	298	-10,962	-20,227	25,797	-8,586	16,765	-38,952
II.	I huaj	64,605	17,500	29,113	32,596	-15,797	15,529	-16,500	51,535
	Hua afatgjatë (e marrë)	17,832	18,780	23,407	83,596	19,600	83,145	24,560	88,287
	Për projekte				21,067	19,600	21,418	24,560	28,560
	Eurobond				62,529		61,727		61,727
	Ndihmat i gjendjes së ardhës	-2,992	-408	169					
	Rapagesat	-61,693	-21,998	-25,769	-52,000	-35,397	-67,615	-41,060	-38,752
	Eurobond				-25,012		-30,863		
	Mbështetje buxhetore (hua nga FMN, BB)	111,458	21,126	31,306	1,000				
MEMO:									
	Balanca e përgjithshme (deficitit përgjithshëm)	-58,202	-26,676	-31,012	-32,366	-32,900	-29,843	-23,165	-22,483
	Balanca korrente	5,857	38,301	46,660	52,035	57,708	62,920	74,120	80,302
	Balanca primare	-19,559	9,583	891	8,634	8,800	17,695	30,313	32,017
	Gjendja e likuiditetit në TSA (stok)	11,962	10,464	21,904	42,131	16,334	24,920	8,155	47,107
	Borhi publik NETO nga gjendja e likuiditetit në TSA (stok)	1,031,250	1,056,102	1,066,191	1,096,733	1,131,487	1,164,174	1,190,287	1,213,010
	Borhi publik BRUTO (stok)	1,043,212	1,066,566	1,088,095	1,138,864	1,147,821	1,189,095	1,196,443	1,250,117
	Borhi publik nga buxheti (stok)	986,242	1,012,241	1,037,457	1,090,000	1,097,103	1,135,533	1,141,933	1,203,367
	I brendshëm (stok)	520,936	530,834	546,939	566,886	589,786	612,686	635,586	645,486
	I huaj (stok)	465,306	481,407	490,518	523,114	507,317	522,848	506,348	557,881
	Borhi publik jashtë buxhetit (stok)	56,970	54,325	50,638	48,864	50,718	53,562	56,510	56,750
	Pushteti vendor (stok)	940	867	753	953	1,153	1,353	1,807	2,200
	Borhi publik i garantuar (stok)	56,030	53,468	49,885	47,911	49,565	52,209	54,703	54,550
	PBB nominal	1,434,307	1,475,251	1,552,868	1,647,625	1,752,736	1,869,208	2,000,323	2,118,680



Lidhja nr. 2/2. Treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar (në përqindje të PBB-së)

Nr.	EMËRTIMI	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
					A.N.2	Buxhet	PBA	PBA	PBA
	TOTALI TË ARDHURAVE	26.4	27.6	27.7	28.0	27.8	27.8	27.8	27.8
I.	Ndihmet	0.8	1.0	0.7	0.7	0.9	0.8	0.8	0.7
II.	Të ardhura tatimore	23.9	25.1	25.7	25.7	25.5	25.6	25.7	25.8
II.1	Nga tatimet dhe doganat	18.0	18.7	18.9	18.9	18.6	18.7	18.8	18.9
II.2	Të ardhura nga pushteti i lokal	0.8	1.0	1.2	1.2	1.3	1.3	1.3	1.3
II.3	Të ardhura nga fondet speciale	5.0	5.4	5.6	5.6	5.7	5.6	5.6	5.6
III.	Të ardhura jo-tatimore	1.8	1.5	1.3	1.6	1.4	1.3	1.2	1.2
	TOTALI I SHPENZIMEVE	30.5	29.4	29.7	30.0	29.6	29.3	28.9	28.8
I.	Shpenzime Korrente	24.5	25.0	24.6	24.8	24.3	24.2	23.8	23.7
I.1	Personeli	5.1	4.6	4.7	4.6	4.6	4.4	4.2	4.2
	Paga	4.4	3.9	4.0	3.9	3.7	3.6	3.5	3.5
	Kontributi për sigurime shoqërore	0.7	0.6	0.6	0.7	0.6	0.6	0.6	0.6
	Fondi i veçantë i pagave	0.0	0.0		0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
	Politika të reja pagash	0.0	0.0			0.1	0.1	0.0	0.1
	Arsimi i lartë nga të ardhurat e veta	0.0	0.0	0.0	0.1	0.1	0.1	0.0	0.0
I.2	Interesat	2.7	2.5	2.1	2.5	2.4	2.5	2.7	2.6
	Të brendshme	1.9	1.7	1.4	1.4	1.4	1.5	1.6	1.6
	Të huaja	0.8	0.7	0.7	0.8	0.7	0.7	0.7	0.7
	Kontingjent për luhatjet e normave të interesit, etj	0.0	0.0		0.2	0.2	0.4	0.4	0.3
I.3	Shpenzime operative e mirëmbajtje	3.0	3.0	2.8	2.8	2.7	2.7	2.7	2.6
	Të qeverisë qendrore (operative & mirëmbajtje)	0.0	0.0	0.0	2.6	2.4	2.5	2.5	2.5
	Arsimi i lartë	0.0	0.0	0.0	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
	Të tjera jashtë limitit	0.0	0.0	0.0	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
I.4	Subvencionet	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
I.5	Shpenzime për fondet speciale	9.8	10.3	10.4	10.4	10.3	10.2	10.0	10.0
	Sigurime shoqërore	7.5	7.7	7.7	7.4	7.5	7.4	7.3	7.3
	Politika të reja pensionesh	0.0	0.0		0.3	0.1	0.1	0.1	0.1
	Sigurime shëndetësore	2.3	2.4	2.5	2.5	2.4	2.3	2.3	2.3
	Shpenzime për kompensimin në vlerë të pronarëve	0.1	0.2	0.3	0.2	0.3	0.3	0.3	0.3
I.6	Buxheti i lokal	2.4	3.0	3.0	3.0	2.9	2.9	2.9	2.9
	Granti nga Buxheti i Shtetit për pushtetin vendor	1.6	1.9	1.8	1.5	1.4	1.4	1.4	1.4
	Fondi i pakushtesuar	0.0	0.0		1.0	1.0	1.0	1.0	1.0
	Granti Specifik	0.0	0.0		0.5	0.4	0.4	0.4	0.4
	Buxheti i lokal (të ardhurat e veta tatimore)	0.8	1.0	1.2	1.2	1.3	1.3	1.3	1.3
	Taksa të ndara	0.0	0.0		0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
	Buxheti i lokal (të ardhurat e veta jo-tatimore)	0.0	0.0		0.2	0.2	0.2	0.2	0.2
	Finançimi i huaj vendor dhe të tjera të mbartura	0.0	0.0		0.1		0.1	0.0	0.1
I.7	Transferta të tjera	1.4	1.5	1.5	1.3	1.4	1.3	1.3	1.3
	Pagëza e papunësisë	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
	Ndihma ekonomike	1.2	1.4	1.3	1.2	1.2	1.1	1.0	1.0
	Kompensim për të përmblirë politikë	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.0	0.0
	Bonus i lindjeve					0.1	0.1	0.1	0.1
II.	Fondi rezervë				0.1	0.2	0.2	0.2	0.3
	Fondi rezervë i Këshillit të Ministrave				0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
	Rezervë për reformën në drejtësi	0.0	0.0			0.1	0.1	0.1	0.1
III.	Shpenzime kapitale	4.4	4.0	4.4	5.1	5.2	5.0	4.9	4.9
	Finançimi i brendshëm	2.7	2.7	3.0	3.2	3.2	3.1	2.9	2.9
	Nga e olat: Fondi për infrastrukturën vendore dhe rajonale	0.0	0.0		0.5	0.3	0.2	0.2	0.2
	Arsimi i lartë nga të ardhurat e veta	0.0	0.0		0.0	0.1	0.1	0.1	0.1
	Finançimi i huaj	1.7	1.4	1.4	1.9	1.9	1.8	1.9	1.9
	Nga të olat: energjia	0.0	0.0	0.0	0.3	0.2	0.2	0.2	0.2
IV.	Detyrimet e prapambetura	1.2	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
V.	Të tjera	0.1	0.4	0.6					
VI.	Fond shpronësimit	0.3		0.1					
	DEFICITI	-4.1	-1.8	-2.0	-2.0	-1.9	-1.6	-1.2	-1.1
	FINANÇIMI DEFICITIT	4.1	1.8	2.0	2.0	1.9	1.6	1.2	1.1
I.	I brendshëm	-0.4	0.6	0.1	0.0	2.8	0.8	2.0	-1.4
	Të ardhura nga privatizimi	0.1	0.2	0.0	0.0				
	Hua-marrje e brendshme (neto)	-1.2	0.7	1.0	1.2	1.3	1.2	1.1	0.5
	Të tjera, nga të olat	0.7	-0.3	-1.0	-1.2	1.5	-0.5	0.8	-1.8
	Ndihimi i gjendjes së likuiditetit në TSA	-0.2	0.0	-0.7	-1.2	1.5	-0.5	0.8	-1.8
II.	I huaj	4.5	1.2	1.9	2.0	-0.9	0.8	-0.8	2.4
	Hua afatgjatë (e marrë)	1.2	1.3	1.5	5.1	1.1	4.4	1.2	4.2
	Per projekte				1.3	1.1	1.1	1.2	1.3
	Eurobond				3.8		3.3		2.9
	Ndihimi i gjendjes së arriës	-0.2	0.0	0.0					
	Rpagesat	-4.3	-1.5	-1.7	-3.2	-2.0	-3.6	-2.1	-1.7
	Eurobond				-1.5		-1.7		
	Mbështetje buxhetore (hua nga FMN, BB)	7.8	1.4	2.0	0.1				
MEMO:									
	Balanca e përgjithshme (deficiti përgjithshëm)	-4.1	-1.8	-2.0	-2.0	-1.9	-1.6	-1.2	-1.1
	Balanca korrente	0.4	2.6	3.0	3.2	3.3	3.4	3.7	3.8
	Balanca primare	-1.4	0.6	0.1	0.5	0.5	0.9	1.5	1.5
	Gjendja e likuiditetit në TSA (stok)	0.8	0.7	1.4	2.6	0.9	1.3	0.4	2.2
	Borxhi publik NETO nga gjendja e likuiditetit në TSA (stok)	71.9	71.6	68.7	66.6	64.6	62.3	59.5	57.3
	Borxhi publik BRUTO (stok)	72.7	72.3	70.1	69.1	65.5	63.6	59.9	59.5
	Borxhi publik nga buxheti (stok)	68.8	68.6	66.8	66.2	62.6	60.7	57.1	56.8
	I brendshëm (stok)	36.3	36.0	36.2	34.4	33.6	32.8	31.8	30.5
	I huaj (stok)	32.4	32.6	31.6	31.7	28.9	28.0	25.3	26.3
	Borxhi publik jashtë buxhetit (stok)	4.0	3.7	3.3	3.0	2.9	2.9	2.8	2.7
	Pushteti vendor (stok)	0.1	0.1	0.0	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
	Borxhi publik i garantuar (stok)	3.9	3.6	3.2	2.9	2.8	2.8	2.7	2.6
	PBB nominal	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0

**VENDIM****Nr. 6, datë 9.1.2019**

**PËR SHPRONËSIMIN, MARRJEN NË
PËRDORIM TË PÛRKOHSHËM DHE
VENDOSJEN E SERVITUTIT TË
KALIMIT PËR PASURITË E
PALUAJTSHME QË PREKEN NGA
PROJEKTI “NDËRTIMI I PRITAVE TË
CILAT PENGOJNË VËRSHIMIN E
LUMENJVE DHE SIGUROJNË
MBROJTJEN E TUBACIONIT, PJESË E
PROJEKTIT TË GAZSJELLËSIT TRANS
ADRIATIC PIPELINE (PROJEKTI TAP)”,
NË ZONAT BERAT, SKRAPAR
DHE FIER**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 7 e 8, të pjesës së parë dhe të pjesës së dytë të shtojcës 1, të marrëveshjes me qeverinë e vendit pritës, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave, dhe Trans Adriatic Pipeline AG, lidhur me projektin e Gazsjellësit Trans Adriatic (Projekti TAP), ratifikuar me ligjin nr. 116/2013, “Për ratifikimin e marrëveshjes me qeverinë e vendit pritës, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave dhe Trans Adriatic Pipeline AG”, dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, marrjen në përdorim të përkohshëm dhe vendosjen e servitutit të kalimit për pasuritë e paluajtshme që preken nga projekti “Ndërtimi i pritave të cilat pengojnë vërshimin e lumenjve dhe sigurojnë mbrojtjen e tubacionit, pjesë e projektit të Gazsjellësit Trans Adriatic Pipeline (projekti TAP)”, në zonat Berat, Skrapar dhe Fier.

2. Shpronësimi, marrja në përdorim të përkohshëm dhe vendosja e servitutit të përhershëm të kalimit mbi këto pasuri të bëhen në favor të shtetit, përfaqësuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, të paraqitur në tabelat A dhe B, bashkëlidhur këtij vendimi, me një vlerë të përgjithshme prej 16 765 938.62 (gjashtëmbëdhjetë milionë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e tridhjetë e tetë pikë gjashtëdhjetë e dy) lekësh, për sipërfaqet:

a) 15 320 (pesëmbëdhjetë mijë e treqind e njëzet) m² që shpronësohet;

b) 32 687 (tridhjetë e dy mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e shtatë) m² që merret në përdorim të përkohshëm;

c) 574 (pesëqind e shtatëdhjetë e katër) m² mbi të cilën vendoset servituti.

4. Marrja në përdorim të përkohshëm për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të jetë me afat 1 (një) vit, për zonat e nevojshme për realizimin e punimeve, për ndërtimin e pritave të cilat pengojnë vërshimin e lumenjve dhe sigurojnë mbrojtjen e tubacionit, sipas tabelës A, bashkëlidhur këtij vendimi.

5. Vlera e përgjithshme prej 16 765 938.62 (gjashtëmbëdhjetë milionë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e tridhjetë e tetë pikë gjashtëdhjetë e dy) lekësh dhe të gjitha shpenzimet e tjera procedurale të përballohen nga shoqëria TAP AG, si subjekt kërkues.

6. Për likuidimin për efekt të shpronësimit, marrjes në përdorim të përkohshëm dhe vendosjes së servitutit mbi pasuritë e pronarëve të përcaktuar në tabelat bashkëlidhur, do të procedohet, si më poshtë vijon:

a) Për të gjitha pasuritë, për të cilat në kolonën përkatëse është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP”, pronarët do të likuidohen pas dorëzimit të dokumentacionit të pronësisë, të lëshuar nga ZVRPP-të përkatëse, kërkesë, kopjen e kartës së identitetit, si dhe vërtetim mbi numrin e llogarisë të lëshuar nga bankat përkatëse/IBAN-in, në zyrat e shoqërisë TAP AG;

b) Për të gjitha pasuritë, për të cilat në kolonën përkatëse nuk është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP”, pronarët do të likuidohen pas konfirmimit të plotë të lëshuar nga ZVRPP-të dhe dorëzimit të dokumentacionit të pronësisë, në zyrat e shoqërisë TAP AG.



7. Përdoruesit e tokës, të cilët kompensohen për kulturat “bujqësore” dhe “drufrutorë”, referuar shumave respektive të pasqyruara në tabelat bashkëlidhur këtij vendimi, duhet të paraqesin për likuidim dokumentet, kërkesën, kopjen e kartës së identitetit, vërtetimin mbi numrin e llogarisë të lëshuar nga bankat përkatëse/IBAN-in, si dhe certifikatën familjare në zyrat e shoqërisë TAP AG.

8. Shoqëria TAP AG të kryejë likuidimet përkatëse, në zbatim të pikave 6 e 7, të këtij vendimi.

9. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, përkatësisht Berat, Skrapar dhe Fier, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës mbi hartat kadastrale, sipas planimetrisë që do t'u vihet në dispozicion nga

TAP AG, si dhe të pezullojnë të gjitha transaksionet për pasuritë, sipas listave bashkëlidhur këtij vendimi, deri në momentin kur do të realizohet regjistrimi i pasurive që shpronësohen, merren në përdorim të përkohshëm dhe mbi të cilat vendoset servituti i kalimit në favor të shtetit.

10. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqëria TAP AG, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, përkatësisht, në Berat, Skrapar dhe Fier për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



RRETHET: BERAT, FIER DHE SKRAPAR

LISTA EMËRORE E PRONARËVE/ PËRDORUESEVE TË PASURIVE QË PREKEN NGA PROJEKTI, “NDËRTIMI I PRITAVE TË CILAT PENGJOJNË VËRSHIMIN E LUMENJVE DHE SIGUROJNË MBROJTJEN E TUBACIONIT, PJESË E PROJEKTIT TË GAZSJELLËSIT TRANS ADRIATIK PIPELINE (PROJEKTI TAP)”

N r.	Pronari/Përdoruesi			ZK.	Nr. Pas.	Lloji Pas.	Sip. m ² për Marrje në Përdorim të Përkohshëm (1 Vit)	Vlera Lekë	Sip. m ² për Servitut	Vlera Lekë	Sip. m ² për shpronës im	Vlera Lekë	Vlera Totale e Kulturave	Objekte Vlera Lekë	Vlera Totale Lekë	Indexi Hartës	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri														
1	Mihal	Qani	Çeta	1342	107/18	Arë	58.00	2,588.25			167.00	59,619.00	55,650.00		117,857.25	K-34-125-(102-D)	Konfirmuar nga ZVRPP
2	Ylli	Sulejman	Zylyftari	1342	110/3	Arë	181.00	6,312.38			40.00	11,160.00	47,176.00		64,648.38	K-34-125-(102-C)	Konfirmuar nga ZVRPP
3	Zylyftar	Barjam	Zylyftari	1342	110/4	Arë	171.00	5,963.63			126.00	35,154.00	158,280.00		199,397.63	K-34-125-(102-D)	Konfirmuar nga ZVRPP
4	Mihal	Qani	Çeta	1342	113/2	Arë	324.00	14,458.50			278.00	99,246.00	209,958.51		323,663.01	K-34-125-(102-C)	Konfirmuar nga ZVRPP
5	Sabri	Zylyftar	Zylyftari	1342	140	Arë	203.00	7,079.63					32,719.27		39,798.90	K-34-125-(102-C)	Konfirmuar nga ZVRPP
6	Novruz	Fejzo	Zylyftari	1342	113/1	Arë	268.00	11,959.50			427.00	152,439.00			164,398.50	K-34-125-(102-C)	Konfirmuar nga ZVRPP
7	Syri	Qani	Zylyftari	1342	113/3	Arë	473.00	21,107.63			346.00	123,522.00			144,629.63	K-34-125-(102-C)	ZVRPP konfirmon se pasuria ka kufizim
8	Myrto	Vesël	Danushi	1270	19/3	Arë	243.00	25,150.50			426.00	352,728.00	7,325.55		385,204.05	K-34-125-(1-B)	Konfirmuar nga ZVRPP
	Rrahime	Arshin	Danushi														
	Ylli	Myrto	Danushi														
	Kosta	Myrto	Danushi														
9	Hysen	Shahin	Demiri	1270	19/4	Arë	436.00	45,126.00			117.00	96,876.00	2,765.00		144,767.00	K-34-125-(1-B)	Konfirmuar nga ZVRPP
10	Flamur	Bekdash	Ruçi	3808	334/15	Arë	164.00	16,974.00			224.00	185,472.00	4,248.60		206,694.60	K-34-113-(225-C)	Konfirmuar nga ZVRPP
11	Kodhel	Bekdash	Ruçi	3808	334/74	Arë	257.00	26,599.50					17,464.86		44,064.36	K-34-113-(225-C)	Konfirmuar nga ZVRPP
12	Kodhel	Bekdash	Ruçi	3808	334/72	Arë	250.00	25,875.00							25,875.00	K-34-113-(225-C)	Konfirmuar nga ZVRPP
13	Kodhel	Bekdash	Ruçi	3808	334/73	Arë					494.00	409,032.00			409,032.00	K-34-113-(225-C)	Konfirmuar nga ZVRPP
14	Vasil	Qani	Kureta	3808	334/18	Arë	488.00	50,508.00			478.00	395,784.00	16,368.87		462,660.87	K-34-113-(225-C)	Konfirmuar nga ZVRPP
15	Isa	Begir	Toska	3808	334/19	Arë	622.00	64,377.00			613.00	507,564.00	305,356.67		877,297.67	K-34-113-(225-C)	Konfirmuar nga ZVRPP
	Andrea	Isa	Mila														
	Aferdita	Isa	Guri														
	Razije	Isa	Kokonozi														
16	Spiro	Çerçiz	Papa	3808	334/31	Arë	675.00	69,862.50			660.00	546,480.00	21,974.10		638,316.60	K-34-113-(225-C)	Konfirmuar nga ZVRPP
17	Hazis	Çerçiz	Merdani	3808	334/32	Arë	552.00	57,132.00			535.00	442,980.00	17,892.02		518,004.02	K-34-113-(225-C)	Konfirmuar nga ZVRPP
18	Hazis	Çerçiz	Merdani	3808	334/34	Arë	352.00	36,432.00			337.00	279,036.00	11,340.94		326,808.94	K-34-113-(225-C)	Konfirmuar nga ZVRPP
19	Dallendyshe	Mehmet	Stromarko	3808	334/35	Arë	424.00	43,884.00			408.00	337,824.00	13,694.72		395,402.72	K-34-113-(225-C)	Konfirmuar nga ZVRPP
	Danica	Aleko	Toska														
	Kleant	Aleko	Stromarko														
20	Behar	Ymer	Toska	3808	334/5	Arë	866.00	89,631.00			230.00	190,440.00	19,103.28		299,174.28	K-34-113-(225-C)	Konfirmuar nga ZVRPP
21	Stones Tomorri" AL. Sh.p.k			3808	334/55	Arë	731.00	22,935.13			700.00	175,700.00	61,387.38		260,022.51	K-34-113-(225-C)	Konfirmuar nga ZVRPP



22	Gezim	Kadri	Toska	3808	334/56	Arë	1,291.00	133,618.50		638.00	528,264.00	21,122.55	683,005.05	K-34-113-(225-C)	Konfirmuar nga ZVRPP
23	Amdi	Ajdar	Agalliu	3808	334/8	Arë	36.00	3,726.00				394.20	4,120.20	K-34-113-(225-C)	Konfirmuar nga ZVRPP
24	Xhevahir	Alit	Çela	3808	412/12	Arë	922.00	95,427.00		588.00	486,864.00	45,074.60	627,365.60	K-34-113-(241-D)	Konfirmuar nga ZVRPP
25	Tetem	Mino	Hoxha	3808	412/13	Arë	490.00	50,715.00		374.00	309,672.00	14,221.44	374,608.44	K-34-113-(241-D)	Konfirmuar nga ZVRPP
26	Niazi	Shaban	Llogaçe	3808	412/14	Arë	271.00	28,048.50		206.00	170,568.00	8,314.11	206,930.61	K-34-113-(241-D)	Konfirmuar nga ZVRPP
27	Fatmir	Niazi	Llogaçe	3808	412/15	Arë	299.00	30,946.50		228.00	188,784.00	8,674.42	228,404.92	K-34-113-(241-D)	Konfirmuar nga ZVRPP
28	Qemal	Shaban	Llogaçe	3808	412/16	Arë	365.00	37,777.50		278.00	230,184.00	10,583.78	278,545.28	K-34-113-(241-D)	Konfirmuar nga ZVRPP
29	Armand	Xhafer	Mollaj	3808	412/17	Arë	155.00	16,042.50		118.00	97,704.00		113,746.50	K-34-113-(241-D)	Konfirmuar nga ZVRPP
30	Perparim	Shaban	Mollaj	3808	412/18	Arë	124.00	12,834.00		94.00	77,832.00	3,588.28	94,254.28	K-34-113-(241-D)	Konfirmuar nga ZVRPP
31	Vrenos	Shasho	Molla	3808	412/19	Arë	314.00	32,499.00		239.00	197,892.00	9,102.38	239,493.38	K-34-113-(241-D)	Konfirmuar nga ZVRPP
32	Qamil	Hatem	Qama	3808	412/20	Arë	153.00	15,835.50		116.00	96,048.00	1,614.00	113,497.50	K-34-113-(241-D)	ZVRPP konfirmon se mbi pasurinë është vendosur sekuestro konservative
33	Alush	Muhamet	Muska	3808	412/21	Arë	245.00	25,357.50		187.00	154,836.00	4,730.40	184,923.90	K-34-113-(241-D)	Konfirmuar nga ZVRPP
34	Refat	Hasim	Hoxhallari	3808	412/24	Arë	284.00	29,394.00		217.00	179,676.00	8,246.46	217,316.46	K-34-113-(241-D)	Konfirmuar nga ZVRPP
35	Halit	Kamber	Çela	3808	412/25	Arë	328.00	33,948.00		250.00	207,000.00	9,513.88	250,461.88	K-34-113-(241-D)	Konfirmuar nga ZVRPP
36	Fadil	Kamber	Çela	3808	412/26	Arë	390.00	40,365.00		297.00	245,916.00	11,308.02	297,589.02	K-34-113-(241-D)	Konfirmuar nga ZVRPP
37	Arben	Kamber	Çela	3808	412/27	Arë	51.00	5,278.50				558.45	5,836.95	K-34-113-(241-D)	Konfirmuar nga ZVRPP
38	Luan	Kamber	Çela	3808	412/28	Arë	60.00	6,210.00				657.00	6,867.00	K-34-113-(241-D)	Konfirmuar nga ZVRPP
39	Kamber	Alit	Çela	3808	412/29	Arë	368.00	38,088.00		365.00	302,220.00	12,776.19	353,084.19	K-34-113-(241-D)	Konfirmuar nga ZVRPP
40	Kici	Miltjadh	Qytyku	3808	412/30	Arë	231.00	23,908.50		176.00	145,728.00	125,645.22	295,281.72	K-34-113-(241-D)	Konfirmuar nga ZVRPP
41	Haki	Deme	Çela	3808	412/32	Arë	1,094.00	113,229.00		834.00	690,552.00	31,734.88	835,515.88	K-34-113-(241-D)	Konfirmuar nga ZVRPP
42	Spiro	Haki	Zhonga	3808	412/33	Arë	355.00	36,742.50		269.00	222,732.00		259,474.50	K-34-113-(241-D)	ZVRPP konfirmon se pasuria ka kufizim
43	Niko	Petro	Gjikondi	3808	412/34	Arë	289.00	29,911.50		221.00	182,988.00		212,899.50	K-34-113-(241-D)	Konfirmuar nga ZVRPP
44	Andrea	Hekuran	Topi	3808	412/35	Arë	462.00	47,817.00		352.00	291,456.00	8,913.30	348,186.30	K-34-113-(241-D)	Konfirmuar nga ZVRPP
45	Leonidha	Hekuran	Topi	3808	412/36	Arë	324.00	33,534.00		247.00	204,516.00	9,952.53	248,002.53	K-34-113-(241-D)	Konfirmuar nga ZVRPP
46	Shpresa	Hekuran	Hoxha	3808	412/37	Arë	333.00	34,465.50		253.00	209,484.00		243,949.50	K-34-113-(241-D)	Konfirmuar nga ZVRPP
47	Foti	Haxhi	Kapinova	3808	412/38	Arë	352.00	36,432.00		268.00	221,904.00	6,789.00	265,125.00	K-34-113-(241-D)	Konfirmuar nga ZVRPP
48	Fetie	Brahim	Braushi	3808	412/39	Arë	309.00	31,981.50		236.00	195,408.00	3,270.00	230,659.50	K-34-113-(241-D)	Konfirmuar nga ZVRPP
	Valbona	Azbi	Braushi												
	Riza	Azbi	Braushi												
49	Luljeta	Veli	Çela	3808	412/40	Arë	368.00	38,088.00		281.00	232,668.00	10,682.54	281,438.54	K-34-113-(241-D)	Konfirmuar nga ZVRPP
	Nertila	Ali	Çela												
	Arjola	Ali	Hatija												
	Franko	Ali	Çela												
	Adem	Kadri	Çela												



	Hasime	Kadri	Bako													
	Lavdie	Kadri	Brami													
	Suzana	Kadri	Cani													
50	Adem	Kadri	Çela	3808	412/41	Arë	233.00	24,115.50		178.00	147,384.00		171,499.50	K-34-125-(1-B)	Konfirmuar nga ZVRPP	
51	Xhevit	Aqif	Çela	3808	412/42	Arë	427.00	44,194.50		325.00	269,100.00	93,797.20	407,091.70	K-34-125-(1-B)	Konfirmuar nga ZVRPP	
52	Myqerem	Aqif	Çela	3808	412/43	Arë	304.00	31,464.00		232.00	192,096.00		223,560.00	K-34-125-(1-B)	Konfirmuar nga ZVRPP	
53	Kujtim	Aqif	Çela	3808	412/44	Arë	434.00	44,919.00		330.00	273,240.00	3,820.00	321,979.00	K-34-125-(1-B)	Konfirmuar nga ZVRPP	
54	Ardian	Neki	Loza	3808	412/48	Arë	203.00	21,010.50		194.00	160,632.00	6,534.62	188,177.12	K-34-125-(1-B)	Konfirmuar nga ZVRPP	
55	Nikolla	Neki	Korraçi	3808	412/69	Arë	112.00	11,592.00		93.00	77,004.00	3,374.30	91,970.30	K-34-125-(1-B)	Konfirmuar nga ZVRPP	
56	Panajot	Jorgo	Koraçi	3808	412/72	Arë	170.00	17,595.00		25.00	20,700.00		38,295.00	K-34-125-(1-B)	Konfirmuar nga ZVRPP	
57	Andon	Hekuran	Topi	3808	437/2	Arë	302.00	31,257.00		5.00	4,140.00	5,351.01	40,748.01	K-34-113-(241-D)	Konfirmuar nga ZVRPP	
58	Elisabeta	Asllan	Gashi	3358	8/5	Arë	590.00	35,500.75				4,038.00	39,538.75	K-34-111-(157-C)	Konfirmuar nga ZVRPP	
59	Klarida	Astrit	Baliqi	3358	8/26	Arë	1,352.00	71,318.00				8,112.00	79,430.00	K-34-111-(157-C)	Konfirmuar nga ZVRPP	
60	Miti	Todi	Çako	3358	255/4	Arë	6,745.00	711,597.50				80,940.00	792,537.50	K-34-111-(173-A)	ZVRPP konfirmon se pasuria ka kufizim	
61	Koli	Nasi	Semini	3300	32/18	Arë			574.00	237,636.00		3,444.00	241,080.00	K-34-111-(176-C)	Konfirmuar nga ZVRPP	
62	Vangjel	Miti	Çuko	3358	255/11	Arë	3,814.00	402,377.00				45,768.00	448,145.00	K-34-126-(56-C)	Konfirmuar nga ZVRPP	
	TOTALI						32.687.00	3.153.117.40	574.00	237.636.00	15.320.00	11.616.248.00	1.625.352.53	-	16.632.353.93	

RRETHET: BERAT DHE SKRAPAR

LISTA EMËRORE E PËRDORUESVE TË PASURIVE ME PRONAR SHTET QË PREKEN NGA PROJEKTI, “NDËRTIMI I PRITAVE TË CILAT PENGJOJNË VËRSHIMIN E LUMENJVE DHE SIGUROJNË MBROJTJEN E TUBACIONIT, PJESË E PROJEKTIT TË GAZSJELLËSIT TRANS ADRIATIK PIPELINE (PROJEKTI TAP)”

Tabela B

Nr.	Pronari	Rrethi	ZK.	Nr. Pas.	Lloji Pas.	Vlera totale e kulturave bujqësore dhe pyjore	Indexi Hartës	Përdoruesi i cili likuidohet vetëm për vlerën e kulturave dhe/ose objektit
1	Shtet	Berat	1270	18	Pyll	1,875.00	K-34-125-(1-B)	Abedin Lushka
2	Shtet	Berat	1270	18	Pyll	295.00	K-34-125-(1-B)	Dylber Lushka
3	Shtet	Berat	1270	18	Pyll	830.00	K-34-125-(1-B)	Jashar Demiri
4	Shtet	Berat	1270	18	Pyll	985.00	K-34-125-(1-B)	Kadri Lushka
5	Shtet	Berat	1270	18	Pyll	775.00	K-34-125-(1-B)	Myrteza Lushka
6	Shtet	Berat	3808	437/33	Arë	6,386.48	K-34-113-(241-D)	Niazi Llogaçe
7	Shtet	Skrapar	1342	107/9	Arë	69,256.30	K-34-125-(102-D)	Mihal Çeta
8	Shtet	Skrapar	1342	100	Arë	41,596.00	K-34-125-(102-C)	Mihal Çeta
9	Shtet	Skrapar	1342	113/16	Arë	6,932.16	K-34-125-(102-C)	Mihal Çeta
10	Shtet	Berat	3808	334/84	Arë	4,653.75	K-34-113-(225-C)	Amdi Agalliu
TOTALI						133,584.69		



RRETHET: BERAT, SKRAPAR DHE FIER

A - LISTA PËRMBLEDHËSE E PASURIVE TË CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I PRITAVE QË PENGJOJNË VËRSHIMIN E LUMENJVE DHE SIGUROJNË MBROJTJEN E TUBACIONIN, PJESË E PROJEKTIT TAP

TOTALI	Sip. m ³ për marje në përdorim të përkohshëm	Vlera lekë	Sip. m ² , për shpronësim	Vlera Lekë	Sip. m ² , për servitut	Vlera Lekë	Kultura Vlera Lekë	Totali Vlera Lekë	Numri i pasurive që preken
	32,687.00	3,153,117.40	15,320.00	11,616,248.00	574.00	237,636.00	1,625,352.53	16,632,353.93	62

B - LISTA E PËRDORUESVE TË PASURIVE ME PRONAR SHTET TË CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I PRITAVE QË PENGJOJNË VËRSHIMIN E LUMENJVE DHE SIGUROJNË MBROJTJEN E TUBACIONIT, PJESË E PROJEKTIT TAP

TOTALI	Kultura Vlera Lekë	Totali Vlera Lekë	Numri i pasurive që preken
	133,584.69	133,584.69	10.00

Totali i sipërfaqes në m ³ që kërkohet të merret në përdorim të përkohshëm është	32,687.00
Totali i sipërfaqes në m ² , që kërkohet të shpronësohet	15,320.00
Totali i sipërfaqes në m ² , që kërkohet për servitut	574.00
Totali i kulturave në lekë	1,758,937.22
Totali i pasurive	72
Vlera totale e kësaj kërkesë për të dyja tabelat A + B është	16,765,938.62

(gjashtëmbëdhjetë milionë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e tridhjetë pikë gjashtëdhjetë e dy) lekë

**VENDIM****Nr. 7, datë 9.1.2019****PËR DHËNIEN E BURSIVE PËR
NXËNËSIT E SHKOLLËS SË MESME
PROFESIONALE “PETER
MAHRINGER”, SHKODËR, PËR VITIN
SHKOLLOR 2018-2019**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6, 19 dhe 39, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9522, datë 25.4.2006, “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Austrisë, për bashkëpunimin në fushat e kulturës, të arsimit dhe shkencës”, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë të 84 (tetëdhjetë e katër) bursave të studimit për nxënës të shkollës së mesme profesionale “Peter Mahringer”, Shkodër, nga të cilat 24 (njëzet e katër) bursa studimi për nxënës të viteve përgatitore dhe 60 (gjashtëdhjetë) bursa studimi për nxënës të viteve të para, deri në vitin e katërt të shkollës së mesme profesionale “Peter Mahringer”, për vitin shkollor 2018-2019.

2. Vlera vjetore e bursës do të jetë 92 820 (nëntëdhjetë e dy mijë e tetëqind e njëzet) lekë, me qëllim shlyerjen e tarifës mujore të shkollimit dhe për mbulimin e kostos së teksteve mësimore. Vlera e masës së bursës do të paguhet pranë bankave të nivelit të dytë për çdo nxënës/prind/përfaqësues ligjor të nxënësve përfitues.

3. Fondi për mbulimin e këtyre bursave kalon nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë në njësinë arsimore vendore Shkodër.

4. Miratimi i këtyre bursave bëhet nga bordi i Fondacionit Shkollor Austriak, në mbështetje të kriterëve ekonomike, si dhe rezultateve të arritura nga secili nxënës/aplikant.

5. Bordi i Fondacionit Shkollor Austriak, pas miratimit të bursave, dërgon dokumentacionin përkatës në njësinë arsimore vendore Shkodër, e cila pas konfirmimit të nxënësve që përfitojnë bursë, kalon masën e bursës në llogarinë personale të secilit nxënës.

6. Efektet financiare të mbulohen nga buxheti vjetor i miratuar për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, pa efekte financiare shtesë në buxhetin e shtetit.

7. Ngarkohet Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM**Nr. 8, datë 9.1.2019****PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR. 787, DATË 22.9.2015,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
PËRBËRJEN E KOMISIONEVE EPRORE
TË CAKTIMIT TË AFTËSISË PËR
PUNË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1, 2 e 3, të nenit 39/2, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 787, datë 22.9.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Shtohet aneksi nr. 3, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Në pikën 3 emërtesat “Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë”, “Ministria e Shëndetësisë” dhe “Ministria e Financave” zëvendësohen, përkatësisht, me “Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale” dhe “Ministria e Financave dhe Ekonomisë”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



ANEKSI NR. 3
EMËRTESAT, KANDIDATURAT DHE SPECIALITETET E KMCA-ve EPRORË
(LISTA ALTERNATIVE)

Nr.	KMCAP	Kandidaturë alternative	Specialiteti
1.	Sëmundje të brendshme (Pneumoni /ftiziatr + patologji) (ISSH)	Dr. Silvana Bala Dr. Mirela Hasanaj	Pneumolog Alergolog
2.	Kardiologji (ISSH)	Prof. Alban Dibra Prof. Arben Baboci Dr. Naltin Shuke	Kardiolog Kardiolog/Kirurg Kardiolog
3.	Neurologji (ISSH)	D.Sh. M Drini Dobi	Neurolog
4.	Kirurgji (ISSH)	D.Sh.M. Silvana Çeliku Dr. Enton Bollano	Gjinekolog/Onkolog Onkolog
5.	Ortopedi (ISSH)	Prof. asc.Artid Duni D. Sh M. Artan Distafa	Ortoped Ortoped
6.	Psikiatri /Okulistikë (ISSH)	Prof. asc. Vilma Mema D. Sh M.Fatime Elezi	Okulist Psikiatër
7.	Sëmundjet e shëndetit mendor (SHSSH)	Dr. Fatos Jaho Prof. asc.Vuksan Kola D. Sh. M Anila Hashorva	Neurolog Psikiatër Psikiatër
8.	Sëmundjet e përgjithshme (SHSSH)	Prof. asc. Valbona Duraj D. Sh. M Arjana Strakosha	Reumatolog Nefrolog
9.	Verbëri (SHSSH)	D. Sh. M Alketa Tandili D. Sh. M Amarildo Belshi	Okulist Okulist
10.	Para- tetraplegji (SHSSH)	Dr. Sh Fatos Olldashi D. Sh. M Arben Rroji Dr. Artan Bano	Neurokirurg Imazherist Ortoped

VENDIM

Nr. 10, datë 9.1.2019

**PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR
PRODHIMIN, IMPORTIN, EKSPORTIN,
HEDHJEN NË TREG DHE
PËRDORIMIN E SUBSTANCAVE
OZONHOLLUESE, SI DHE PËR
IMPORTIN, EKSPORTIN, HEDHJEN NË
TREG DHE PËRDORIMIN E
PRODUKTEVE E TË PAJISJEVE QË
PËRMBAJNË KËTO SUBSTANCA¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 35, të ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave për prodhimin,

importin, eksportin, hedhjen në treg dhe përdorimin e substancave ozonholluese, si dhe për importin, eksportin, hedhjen në treg dhe përdorimin e produkteve e të pajisjeve që përmbajnë këto substanca, sipas tekstit dhe shtojcave, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Vendimi nr. 453, datë 23.6.2005, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së pajisjeve, që përdorin lëndë ozonholluese, të cilat ndalohen të prodhohen e të importohen, si dhe rregullat e procedurat e zëvendësimit të lëndëve ozonholluese në pajisjet ekzistuese”, të ndryshuar, shfuqizohet.

3. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

¹ Ky vendim përshfaqon:

□ pjesërisht me rregulloren (EC) nr. 1005/2009, të Parlamentit dhe Këshillit Evropian, të datës 16 shtator 2009, mbi substancat që hollonë shtresën e ozonit; (e amenduar) CELEX 32009R1005, OJ L 286, 31.10.2009;

□ pjesërisht rregulloren e komisionit (EU) 291/2011, e datës 24 mars 2011, për përdorimin thelbësor të substancave të kontrolluara përveç hidrofluorokarbonëve për laboratorët dhe për qëllime analitike në Bashkimin Evropian sipas rregullores (EC) 1005/2009, të Parlamentit dhe të Këshillit Evropian për substancat që hollonë shtresën e ozonit, CELEX 3A32011R0291, OJ L 79/4, 25.03.2011;

□ pjesërisht me rregulloren e komisionit (EU) 744/2010, të datës 18 gusht 2010, e cila amendon rregulloren (EC) 1005/2009, të Parlamentit dhe të Këshillit Evropian, për substancat që hollonë shtresën e ozonit në lidhje me përdorimet kritike të haloneve; CELEX 32010R0744, OJ L 218, 19.8.2010.

**RREGULLAT**

PËR PRODHIMIN, IMPORTIN, EKSPORTIN, HEDHJEN NË TREG DHE PËRDORIMIN E SUBSTANCave OZONHOLLUESE, SI DHE PËR IMPORTIN, EKSPORTIN, HEDHJEN NË TREG DHE PËRDORIMIN E PRODUKTEVE E TË PAJISJEVE QË PËRMBAJNË KËTO SUBSTANCA

I. OBJEKTI

Objekt i këtyre rregullave janë prodhimi, importi, eksporti, hedhja në treg, përdorimi i substancave ozonholluese, si dhe importi, eksporti, hedhja në treg dhe përdorimi i produkteve e i pajisjeve që përmbajnë këto substanca.

II. PËRKUFIZIME

Me termat e mëposhtëm, për qëllim të këtyre rregullave, nënkuptojmë:

1. “Bromuri i metilit”, substancë e kontrolluar, e listuar në aneksin (E), grupi I, të shtojcës 1, bashkëlidhur këtyre rregullave.

2. “Eksport”, dalja nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë e substancave të kontrolluara, si dhe e produkteve dhe pajisjeve që përmbajnë këto substanca.

3. “Lëndë e parë/Feedstock”, çdo substancë e kontrolluar ose substancë e re, që i nënshtrohet transformimit kimik në një proces, gjatë të cilit ajo është transformuar plotësisht nga përbërja e saj origjinale dhe shkarkimet e saj janë të papërfillshme.

4. “Halon”, substancat e kontrolluara të renditura në aneksin A, grupi II, të shtojcës 1, bashkëlidhur këtyre rregullave, duke përfshirë dhe izomerët e tyre.

5. “Hidroklorofluorokarbon” ose “HCFC”, substancat e kontrolluara të listuara në aneksin C, grupi I, të shtojcës 1, bashkëlidhur këtyre rregullave, duke përfshirë dhe izomerët e tyre.

6. “Import”, hyrja e substancave të kontrolluara dhe e produkteve dhe pajisjeve që përmbajnë këto substanca, në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

7. “Klorofluorokarbon” ose “CFC”, substancat e kontrolluara të listuara në anekset (A & B), grupi I, të shtojcës 1, bashkëlidhur këtyre rregullave, duke përfshirë dhe izomerët e tyre.

8. “Konsum”, prodhim plus import minus eksportet e substancave të kontrolluara.

9. “Kontejner”, një produkt, i cili është projektuar kryesisht për transportimin ose ruajtjen e substancave të kontrolluara.

10. “Kontejner pa rimbushje”, një kontejner i cili nuk mund të rimbushet pa u përshtatur për këtë qëllim ose është vendosur në treg pa parashikuar rikthimin apo rimbushjen e tij.

11. “Nomenklatura e Kombinuar e Mallrave”, ka kuptimin që i jepet në ligjin nr. 102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

12. “Njësia Kombëtare e Ozonit (NJKO)”, organizmi përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të kërkesave të Protokollit të Montrealit në shkallë kombëtare, i krijuar pranë ministrisë përgjegjëse për mjedisin, me mbështetjen financiare të sekretariatit të ozonit.

13. “Operator”, një person fizik ose juridik, të cilit i janë deleguar nga sipërmarrësi funksionet teknike të produkteve dhe pajisjeve që përmbajnë substanca të kontrolluara.

14. “Palë”, çdo shtet që ka ratifikuar Protokollin e Montrealit.

15. “Përdorim”, përdorimi i substancave të kontrolluara ose i substancave të reja në proceset e prodhimit, mirëmbajtjes ose shërbimit, duke përfshirë rimbushjen e produkteve dhe pajisjeve ose në procese të tjera çfarëdo.

16. “Përdorim karantinor”, trajtimet për të parandaluar futjen, krijimin apo përhapjen e parazitëve karantinor (duke përfshirë sëmundjet), ose për të siguruar kontrollin e tyre zyrtar, ku:

a) kontrolli zyrtar është ai që kryhet nga, ose është i autorizuar nga, një autoritet kombëtar përgjegjës për mbrojtjen e bimësisë, kafshëve, mjedisit dhe shëndetit;

b) parazit karantinor është një parazit i rrezikshëm, me ndikim të rëndësishëm ekonomik, që nuk është vërejtur ose është vërejtur në vendin tonë, por nuk është i përhapur gjerësisht dhe kontrollohet zyrtarisht në mënyrë aktive.

17. “Përdorim laboratorik dhe analitik”, përdorim i substancave të kontrolluara për përdorimet e specifikuar në shtojcën 5, bashkëlidhur këtyre rregullave.

18. “Përdorim përpara nisjes”, ato përdorime jokarantinore aplikuar jo më shumë se 21 (njëzet e një) ditë para eksportit, për të përmbushur kërkesat zyrtare të vendit importues ose kërkesat zyrtare të vendit eksportues. Kërkesat zyrtare janë ato të cilat kryhen nga, ose janë të autorizuar nga, një autoritet



kombëtar përgjegjës për kafshët, mjedisin, shëndetin ose për produktet e magazinuara.

19. “Përdorim thelbësor i halonit”, ato përdorime të halonit të listuara në shtojcën 6, bashkëlidhur këtyre rregullave.

20. “Pompë nxehtësie”, një pajisje ose instalim që rikuperon nxehtësinë në temperatura të ulëta nga ajri, uji apo nëntoka dhe e transferon atë në një mjedis tjetër.

21. “Potenciali ozonhollues” ose “POH”, vlera numerike e përcaktuar në kolonën e tretë, të shtojcës 1 dhe përfaqëson efektin potencial që çdo substancë e kontrolluar ose substancë e re, ka në shtresën e ozonit.

22. “Produktet dhe pajisjet që përmbajnë substanca të kontrolluara”, produktet dhe pajisjet të cilat përdorin dhe/ose përmbajnë substanca të kontrolluara dhe nuk funksionojnë pa ato, sipas shtojcës 3, që i bashkëlidhet këtyre rregullave, duke mospërfshirë ato produkte dhe pajisje që përdoren për prodhimin, përpunimin, rigjenerimin, riciklimin, rikuperimin, apo shkatërrimin e substancave të kontrolluara.

23. “Prodhim”, ka të njëjtin kuptim me atë të dhënë në “Protokollin e Montrealit për substancat që hollojnë shtresën e ozonit”, ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 8463, datë 10.3.1999, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Vjenës “Për mbrojtjen e shtresës së ozonit” dhe Protokollin e Montrealit “Për substancat që hollojnë shtresën e ozonit””.

24. “Protokoll i Montrealit” nënkupton protokollin “Për substancat që hollojnë shtresën e ozonit”, i nënshkruar në Montreal, në vitin 1987, me ndryshimet përkatëse, në të cilin Republika e Shqipërisë ka aderuar me ligjin nr. 8463, datë 10.3.1999, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Vjenës “Për mbrojtjen e shtresës së ozonit” dhe Protokollin e Montrealit “Për substancat që hollojnë shtresën e ozonit””.

25. “Rigjenerim”, ripërpunimi i një substance të kontrolluar që është rikuperuar, në mënyrë që të plotësojë një standard specifik performance të një substance të virgjër, duke marrë në konsideratë qëllimin e përdorimit të saj.

26. “Riciklim”, ripërdorimi i një substance të kontrolluar, i rikuperuar më parë nëpërmjet një procesi bazik pastrimi.

27. “Rikuperim”, mbledhja, grumbullimi dhe depozitimi i substancave të kontrolluara nga

produktet dhe pajisjet që përmbajnë këto substanca, ose kontejnerë, gjatë mirëmbajtjes, shërbimit apo para asgjësimit të produkteve ose pajisjeve që përmbajnë substanca të kontrolluara.

28. “Sasia e substancave të kontrolluara që do të importohet”, sasia maksimale që do të importohet, e përcaktuar në përputhje me kuotat vjetore, të paraqitura në shtojcën 4, që i bashkëlidhet këtyre rregullave.

29. “Sekretariati i ozonit”, Sekretariati i Protokollit të Montrealit.

30. “Sipërmarrës i substancave të kontrolluara”, çdo person fizik ose juridik, i cili kryen një ose disa nga aktivitetet e mëposhtme:

a) Prodhon, rikuperon, riciklon, rigjeron, përdor ose shkatërron substanca të kontrolluara apo substanca të reja;

b) Importon substanca të tilla dhe/ose pajisje që përmbajnë këto substanca;

c) Eksporton substanca të tilla dhe/ose pajisje që përmbajnë ato;

ç) Vendos në treg substanca të tilla; ose

d) Instalon, kryen shërbime, mirëmban, riparon, kontrollon për rrjedhje ose çmonton/heq nga përdorimi pajisjet që përmbajnë, apo funksionimi i të cilave mbështetet në Substanca të Kontrolluara;

dh) Është operatori i produkteve dhe pajisjeve që përmbajnë substanca të kontrolluara.

31. “Substanca të kontrolluara”, substancat ozonholluese të listuara në shtojcën 1, që i bashkëlidhet këtyre rregullave, duke përfshirë dhe izomerët e tyre, të gjendura qoftë vetëm ose në një përzierje, apo substanca të virgjëra, të rikuperuara, të ricikluara ose të rigjeneruara.

32. “Substanca të reja”, substancat e listuara në shtojcën 2, të cilat gjenden vetëm ose në një përzierje, ose substanca të virgjëra, të rikuperuara, të ricikluara ose të rigjeneruara.

33. “Substanca të virgjëra”, substanca të cilat nuk janë përdorur më parë.

34. “Shkatërrim”, procesi, me anë të të cilit pothuajse të gjitha ose një pjesë e substancave të kontrolluara transformohen në mënyrë të përhershme ose zbërthehen në një ose më shumë substanca të qëndrueshme, të cilat nuk janë më substanca të kontrolluara.

35. “Tetrakloruri i karbonit”, substanca e kontrolluar e renditur në aneksin B, grupin II, të shtojcës 1, bashkëlidhur këtyre rregullave.



36. “Vendosja në treg (VNT)”, furnizimi ose vënia në dispozicion të një malli te personat e tretë, brenda territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, me ose pa pagesë, përfshirë nxjerrjen në qarkullim të lirë, siç referohet në Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar. Për sa i përket produkteve dhe pajisjeve që janë pjesë e një pasurie të paluajtshme apo pjesë e mjeteve të transportit, VNT i referohet vetëm furnizimit ose vënies në dispozicion brenda territorit të Republikës së Shqipërisë për herë të parë.

III. FUSHA E ZBATIMIT

Këto rregulla zbatohen për të gjitha subjektet fizike ose juridike, që prodhojnë, importojnë, eksportojnë, hedhin në treg, rigjenerojnë, riciklojnë, rikuperojnë, shkatërrojnë, përdorin, substanca të kontrolluara ose produkte dhe pajisje që përmbajnë këto substanca në territorin e Republikës së Shqipërisë.

IV. NDALIMET

1. Përveç rasteve kur, në mënyrë të shprehur, parashikohet ndryshe në këto rregulla, në Republikën e Shqipërisë janë të ndaluara:

a) Prodhimi i substancave të kontrolluara, i përzierjeve, si dhe produkteve e pajisjeve që përmbajnë këto substanca;

b) Shkarkimi në ajër i substancave të kontrolluara dhe i përzierjeve që përmbajnë këto substanca;

c) Importi, eksporti i substancave të kontrolluara, si dhe i produkteve dhe pajisjeve që përmbajnë substanca të kontrolluara nga dhe te çdo shtet që është palë e Protokollit të Montrealit, me përjashtim të rasteve dhe sipas rregullave të përcaktuara më poshtë në pikën 6, të kreut VI, të këtyre rregullave;

ç) Importi, eksporti i substancave të kontrolluara, si dhe i produkteve dhe pajisjeve që përmbajnë substanca të kontrolluara nga dhe te çdo shtet që nuk është palë e Protokollit të Montrealit;

d) Vendosja në treg dhe përdorimi i substancave të kontrolluara, me përjashtim të rasteve dhe sipas rregullave të përcaktuara më poshtë, në pikën 5, të kreut V, të këtyre rregullave;

dh) Përdorimi i substancave të kontrolluara, si dhe i produkteve dhe pajisjeve që përmbajnë këto substanca, të cilat përdoren në bujqësi për

mbrojtjen e bimëve, me përjashtim të rasteve dhe sipas rregullave të përcaktuara më poshtë, në pikën 6, të kreut V, të këtyre rregullave.

2. Importi i pajisjeve ftohëse të përdorura që përmbajnë substanca të kontrolluara.

V. VENDOSJA NË TREG DHE KONTROLLI I PËRDORIMIT

1. Substancat e kontrolluara lejohet të vendosen në treg vetëm në kontejner rimbushës, përjashtimisht rasteve për përdorime laboratorike dhe analitike.

2. Halonet lejohet të vihen në treg dhe të përdoren vetëm për përdorimet thelbësore të listuara në shtojcën 6, bashkëlidhur këtyre rregullave. Përdorimi dhe vendosja në treg bëhet vetëm nga sipërmarrës të substancave të kontrolluara, të autorizuar nga ministria përgjegjëse për mjedisin, si autoriteti kompetent përgjegjës për depozitimin e haloneve për përdorime thelbësore.

3. Hidrokloroflorokarbonet lejohet të prodhohen, vendosen në treg dhe përdoren sipas kuotave të lejuara, të përcaktuara në shtojcën 4, të këtyre rregullave.

4. Hidrokloroflorokarbonet e rikuperuara lejohen të vendosen në treg dhe të përdoren për mirëmbajtjen ose shërbimin e pajisjeve ekzistuese të ftohjes, ajrit të kondicionuar dhe pompave të nxehtësisë, me kusht që kontejneri të jetë i etiketuar sipas kushteve dhe parashikimeve të përcaktuara në pikën 3, të kreut IX, të këtyre rregullave.

5. Bromuri i metilit lejohet të vendoset në treg dhe të përdoret për përdorim karantinor dhe për trajtimin e mallrave për eksport, përpara transfertës së tyre.

6. Bromuri i metilit lejohet të përdoret vetëm:

a) në rastet e miratuara nga ministria përgjegjëse për mjedisin; dhe

b) nëse përdorimi i tij është ekonomikisht dhe teknikisht alternativa më e mirë; si dhe

c) me kusht që të paktën 80% (tetëdhjetë) për qind e bromurit të metilit lëshuar nga ngarkesa të rikuperohet.

VI. KONTROLLET MBI IMPORTIN DHE EKSPORTIN

1. Importi i substancave të kontrolluara të përfshira në aneksin C, të grupit I, të shtojcës 1, të këtyre rregullave, realizohet vetëm nga subjekte të licencuara dhe lejohet vetëm mbi bazën e kuotave



vjetore, të përcaktuara në shtojcën 4, të këtyre rregullave. Ministri përgjegjës për mjedisin, nëpërmjet një udhëzimi të veçantë, përcakton mënyrën e ndarjes së kuotave vjetore të importit të substancave të kontrolluara, sipas shtojcës 4, të këtyre rregullave.

2. Në raste të veçanta, për substancat e kontrolluara, përveç hidroklorofluorkarboneve, mund të bëhen përjashtime nga ndalimet e importit të përshkruara në shkronjën “c”, të pikës 1, të kreut IV, të këtyre rregullave, kur duhet mbrojtur jeta e njerëzve, larmia biologjike, siguria kombëtare, kërkimet shkencore ose për të përballuar fatkeqësitë natyrore. Ky përjashtim lejohet kur argumentohet se nuk ka zgjidhje të tjera nga pikëpamja mjedisore ose zgjidhjet e tjera janë ekonomikisht të papërballueshme.

3. Çdo përjashtim sipas pikës 2, të këtij kreu, bëhet me urdhër të ministrit përgjegjës për mjedisin, në bazë të kërkesës së argumentuar të organit përkatës shtetëror, ku përcaktohen lloji dhe sasia e substancës së kontrolluar që duhet importuar, vendi nga do të importohet dhe koha e lëvrimit, pasi është marrë paraprkishtë miratimi me shkrim nga Sekretariati i Ozonit.

4. Importimi i substancave të kontrolluara lejohet vetëm në degët doganore, të cilat kanë personel të trajnuar, si dhe pajisje për identifikimin e substancave ozonholluese.

5. Importi dhe eksporti i produkteve dhe pajisjeve që përmbajnë substanca të kontrolluara bëhen nga sipërmarrës të këtyre substancave, të licencuar sipas kreut VII, të këtyre rregullave.

6. Ndalimi i importit i përcaktuar në pikën 1, të kreut IV, të këtyre rregullave nuk aplikohet për importet e:

a) substancave të kontrolluara që përdoren për përdorime laboratorike dhe analitike;

b) substancave të kontrolluara që përdoren si lëndë e parë/*feedstock*;

c) substancave të kontrolluara për shkatërrim nga teknologji të miratuara, të përcaktuara në shtojcën 7, që i bashkëlidhet këtyre rregullave;

ç) produkteve dhe pajisjeve që përmbajnë halone për të përmbushur përdorimet thelbësore;

d) produkteve dhe pajisjeve që përmbajnë substanca të kontrolluara për të kryer përdorime laboratorike dhe analitike;

dh) produkteve dhe pajisjeve që përmbajnë substanca të kontrolluara për shkatërrim, aty ku

është e aplikueshme nga teknologjitë e miratuara;

e) haloneve të rikuperuar, ricikluar apo rigjeneruar, të depozituar për përdorimet thelbësore të haloneve nga sipërmarrës të autorizuar nga autoriteti kompetent përgjegjës për depozitim të haloneve për përdorime thelbësore;

ë) bromurit të metilit të përdorur në raste emergjence për ripaketim dhe riekспорт të mëtejshëm për përdorim karantinor dhe përdorim përpara nisjes, me kusht që riekporti të bëhet gjatë vitit të importit;

f) substancave të kontrolluara, përveç hidroklorofluorkarboneve, në përputhje me pikat 2 e 3, të këtij kreu.

7. Ndalimi i eksportit i përcaktuar në pikën 1, shkronja “c”, të kreut IV, të këtyre rregullave, nuk aplikohet për eksportet e:

a) substancave të kontrolluara që përdoren për përdorime laboratorike dhe analitike;

b) substancave të kontrolluara që përdoren si lëndë e parë/*feedstock*;

c) haloneve të rikuperuar, ricikluar apo rigjeneruar, të depozituar për përdorimet thelbësore të haloneve nga sipërmarrës të autorizuar ose produkteve dhe pajisjeve që përmbajnë halone për të përmbushur përdorimet thelbësore;

ç) HCFC-ve të virgjër apo të rigjeneruar për përdorime të tjera joshkatërruese;

d) bromurit të metilit të riekportuar për përdorim karantinor dhe përdorim përpara nisjes.

VII. LICENCIMI

1. Importi dhe/ose eksporti i substancave të kontrolluara kryhet vetëm nga sipërmarrës të pajisur me licencë, Kodi III.3, në përputhje me kriteret, kushtet, afatet dhe procedurat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë.

2. Ministri përgjegjës për mjedisin nxjerr urdhër për dokumentacionin e nevojshëm për sipërmarrësit, që duhet të plotësojnë për përmbushjen e kriterëve sipas legjislacionit për licencat, përfshirë edhe detyrimin e raportimit sipas kërkesave të kreut XI.

3. Ministri përgjegjës për mjedisin, në rast të moszbatimit të detyrimeve ligjore dhe nënligjore në këtë fushë, pezullon dhe/ose revokon licencën në përputhje me legjislacionin për licencat.



VIII. ETIKETIMI

1. Importuesi i substancave të kontrolluara apo pajisjeve dhe substancave që përmbajnë substanca të kontrolluara duhet të sigurojnë etiketimin e tyre në gjuhën shqipe. Etiketa përmban emërtimin tregtar, përbërjen kimike, Kodin e Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave (Kodin NK), simbolin e rrezikut me shenjë, në përputhje me klasifikimin ndërkombëtar ISO, njoftimet për rrezikshmërinë për shëndetin dhe mjedisin, kërkesat për sigurinë dhe kushtet e depozitimit, si dhe sasinë e përgjithshme të lëndës së ambalazhuar, datën e prodhimit dhe të skadimit, si dhe kontaktin e importuesit.

2. Substancat e kontrolluara, të prodhuara ose të vendosura në treg për përdorime laboratorike dhe analitike, lëndë e parë/*feedstock* dhe ato për shkatërrim mund të përdoren vetëm për qëllimet e caktuara. Kontejnerët që përmbajnë substanca të tilla do të etiketohen me një tregues të qartë se substanca mund të përdoret vetëm për qëllimet e caktuara.

3. Etiketimi për hidrokloroflorokarbonet të ricikluara ose të rikuperuara që përdoren për mirëmbajtjen ose shërbimin e pajisjeve ftohëse, të ajrit të kondicionuar dhe pompave të nxehtësisë, duhet të përfshijë një tregues për llojin e substancës, sasinë e substancës që ndodhet në pajisje, emrin e adresën e sipërmarrësit që ka kryer rigjenerimin ose riciklimin dhe elemente etiketuese lidhur me rrezikshmërinë për shtresën e ozonit, si për shembull fjalë sinjalizuese për rrezikun dhe deklarata parandaluese.

IX. KONTROLI I RRJEDHJEVE DHE SHKARKIMEVE TË SUBSTANCAVE TË KONTROLLUARA

1. Sipërmarrësit e substancave të kontrolluara duhet të marrin të gjitha masat për të parandaluar dhe minimizuar çdo rrjedhje dhe emetim të substancave të kontrolluara në mjedis.

2. Sipërmarrësit e substancave të kontrolluara ose operatorët që vënë në funksionim, instalojnë, kryejnë shërbime, mirëmbajnë, riparojnë, çmontojnë pajisje ftohëse, të ajrit të kondicionuar, pajisje me pompë nxehtësie, sisteme kundër zjarrit, (duke përfshirë edhe sistemet e qarqeve të tyre), të cilat përmbajnë substanca të kontrolluara, duhet të marrin masa që:

a) pajisjet ose sistemet stacionare me ngarkesë fluide të substancave të kontrolluara - 3 kg ose më shumë – të kontrollohen të paktën një herë në 12 (dymbëdhjetë) muaj. Kjo nuk zbatohet për pajisjet me sistemet e mbyllur hermetikisht, të cilat janë etiketuar si të tilla dhe që përmbajnë më pak se 6 kg substanca të kontrolluara;

b) pajisjet ose sistemet stacionare me ngarkesë fluide të substancave të kontrolluara – 30 kg ose më shumë – të kontrollohen të paktën një herë në 6 (gjashtë) muaj;

c) pajisjet ose sistemet e palëvizshme/stacionare me ngarkesë fluide të substancave të kontrolluara – 300 kg ose më shumë – të kontrollohen të paktën një herë në çdo 3 (tre) muaj.

3. Çdo rrjedhje që zbulohet/vihet re duhet të riparohet sa më shpejt të jetë e mundur dhe jo më vonë se 14 (katërmëdhjetë) ditë kalendarike. Pajisja apo sistemi, do të kontrollohet brenda 1 (një) muaji pas konstatimit të rrjedhjes për t'u siguruar se riparimi ka qenë efektiv.

4. Sipërmarrësit dhe operatorët e substancave të kontrolluara, të përcaktuar në pikën 2, të këtij kreu, krijojnë dhe mbajnë të dhëna në lidhje me:

a) sasinë dhe llojin e substancave të kontrolluara;

b) sasitë e substancave të kontrolluara që janë shtuar gjatë instalimit, mirëmbajtjes, shërbimit ose për shkak të asgjësimit përfundimtar të pajisjeve apo sistemeve të referuar në pikën 2, të këtij kreu;

c) sasitë e substancave të kontrolluara që janë rikuperuar gjatë instalimit, mirëmbajtjes, shërbimit ose për shkak të asgjësimit përfundimtar të pajisjeve apo sistemeve të referuar në pikën 2, të këtij kreu;

ç) gjenealogjetet e kompanisë ose teknikut që kryen shërbimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve apo sistemeve, duke përfshirë edhe numrin e certifikatës së tij;

d) datat e rrjedhjeve dhe rezultatet pas çdo kontrolli të kryer për rrjedhje.

5. Sipërmarrësit e substancave të kontrolluara dhe operatorët duhet të mbajnë të dhëna për të paktën 5 (pesë) vjet.

6. Format i ruajtjes së të dhënave të kontrollit nga rrjedhjet për sipërmarrësit e substancave të kontrolluara ose operatorët miratohet me urdhrë të ministrit përgjegjës për mjedisin.



X. RIKUPERIMI DHE SHKATËRRIMI I SUBSTANCAVE TË KONTROLLUARA

1. Substancat e kontrolluara që gjenden në pajisjet e ftohjes, ajrit të kondicionuar dhe pompave të nxehtësisë, pajisjeve që përmbajnë tretës ose sistemeve të mbrojtjes nga zjarri dhe fikset e zjarrit duhet që gjatë shërbimit të mirëmbajtjes, riparimit të pajisjes ose përpara shkatërrimit ose çmontimit të pajisjeve duhet të rikuperohen për shkatërrim, riciklim ose rigjenerim.

2. Substancat e kontrolluara, si dhe produktet dhe pajisjet që përmbajnë substanca të tilla, do të shkatërrohen vetëm me teknologjitë e të listuara në shtojcën 7, që i bashkëlidhet këtyre rregullave. Në rastin e substancave të kontrolluara që nuk gjenden në këtë shtojcë, shkatërrimi i tyre do të bëhet me teknologjitë e shkatërrimit më të pranueshme nga ana mjedisore, pa kosto shtesë, dhe me kusht që përdorimi i këtyre teknologjive të jetë në përputhje me legjislacioni kombëtar për menaxhimin e integruar të mbetjeve.

3. Substancat e kontrolluara që gjenden në produkte dhe pajisje të ndryshme nga ato të përmendura në pikën 1, të këtij kreu, nëse është teknikisht dhe ekonomikisht e mundshme, do të rikuperohen për shkatërrim, riciklim ose rigjenerim ose do të shkatërrohen pa rikuperim paraprak, duke zbatuar teknologjitë e përmendura në pikën 2, të këtij kreu.

4. Veprimtaria e grumbullimit, transportimit, ruajtjes, riciklimit, përpunimit apo asgjësimit të substancave të kontrolluara bëhet vetëm nga subjekte të pajisura me licencën “Veprimtaritë e tjera profesionale lidhur me ndikimin në mjedis”, me kodin III.2.B.

XI. RAPORTIMI

1. Të dhënat për prodhimin, importin, eksportin, hedhjen në treg, përdorimin, rigjenerimin, riciklimin, rikuperimin, shkatërrimin, e substancave ozonholluese, si dhe produkteve dhe të pajisjeve që përmbajnë këto substanca sigurohen nëpërmjet regjistrave përkatës.

2. Forma e regjistrimit të substancave të kontrolluara, mënyra e komunikimit, e këshillimit dhe e raportimit të të dhënave të tij, miratohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për mjedisin.

3. Duke filluar nga data 31 mars 2019 dhe çdo vit pasues, çdo sipërmarrës ose operator që prodhon, importon, eksporton, hedh në treg, përdor, rigjeneron, riciklon, rikuperon, shkatërrojnë substanca të kontrolluara apo produkteve dhe pajisjeve që përmbajnë këto substanca, duhet të raportojë zyrtarisht pranë ministrisë përgjegjëse për mjedisin, si dhe NJKO-së të dhënat e specifikuar në shtojcën 9, bashkëlidhur këtyre rregullave.

4. Regjistrat mbajnë edhe:

a) personat fizikë ose juridikë, që importojnë, eksportojnë, përdorin ose përpunojnë substancat e kontrolluara;

b) Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, për sasitë dhe llojin substancave të kontrolluara të importuara dhe/ose të eksportuara.

XII. TRAJNIMI DHE CERTIFIKIMI

1. Kërkesat minimale për programet e trajnimit, dëshmime të trajnimeve, organizimi i testimit teorik dhe praktik, sistemi i vlerësimit dhe procesi i certifikimit për personat fizikë dhe sipërmarrësit e substancave të kontrolluara do të realizohet sipas rregullave të parashikuara në legjislacionin në fuqi për gazet serrë të florinuara.

2. Trajnimit dhe certifikimit i nënshtrohen personat fizikë dhe sipërmarrësit e substancave të kontrolluara që kryejnë:

a) instalimin, mirëmbajtjen ose shërbimin, riparimin ose asgjësimin e produkteve dhe pajisjeve që përmbajnë substanca të kontrolluara;

b) kontrollin e rrjedhjeve të produkteve dhe pajisjeve që përmbajnë substanca të kontrolluara;

c) rikuperimin e substancave të kontrolluara të produkteve dhe pajisjeve që përmbajnë substanca të kontrolluara.

XIII. SANKSIONET

Shkeljet e këtyre rregullave, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen sipas shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 69, të ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar.



SHTOJCA 1
LISTA E SUBSTANCAVE TË KONTROLLUARA

Substancat ozonholluese	Formula kimike	Simboli	Potenciali ozonhollues	Kodi NK
Aneksi A, grupi I; klorofluorkarbonet				
Triklorofluorometani	CFCl ₃	CFC – 11	1.0	2903.77.60
Diklorodifluorometani	CF ₂ Cl ₂	CFC – 12	1.0	
Triklorotrifluoroetani	C ₂ F ₃ Cl ₃	CFC – 113	0.8	
Diklorotetrafluoroetani	C ₂ F ₄ Cl ₂	CFC – 114	1.0	
Kloropentafluoroetani	C ₂ F ₅ Cl	CFC – 115	0,6	
Aneksi A, grupi II; halonet				
Klorobromodifluorometani	CF ₂ BrCl	Halon-1211	3.0	2903.76.10
Bromotrifluorometani	CF ₃ Br	Halon-1301	10.0	2903.76.20
Dibromotetrafluoroetani	C ₂ F ₄ Br ₂	Halon-2402	6.0	2903.76.90
Aneksi B, grupi I; klorofluorkarbonet e tjera plotësisht të halogjenuara				
Klorotrifluorometani	CF ₃ Cl	CFC – 13	1.0	2903.77
Pentaklorofluoroetani	C ₂ FCl ₅	CFC – 111	1.0	
Tetraklorodifluoroetani	C ₂ F ₂ Cl ₄	CFC – 112	1.0	
Heptaklorofluoropropani	C ₃ FCl ₇	CFC – 211	1.0	
Hekzaklorodifluoropropani	C ₃ F ₂ Cl ₆	CFC – 212	1.0	
Pentaklorotrifluoropropani	C ₃ F ₃ Cl ₅	CFC – 213	1.0	
Tetraklorotetrafluoropropani	C ₃ F ₄ Cl ₄	CFC – 214	1.0	
Pentakloropentafluoropropani	C ₃ F ₅ Cl ₅	CFC – 215	1.0	
Dikloroheksafluoropropani	C ₃ F ₆ Cl ₂	CFC – 216	1.0	
Kloroheptafluoropropani	C ₃ F ₇ Cl	CFC – 217	1.0	
Aneksi B, grupi II; tetrakloruri i karbonit				
Tetrakloruri i karbonit	CCl ₄	Tetrakloruri i karbonit	1.1	2903.14.00
Aneksi B, grupi III; trikloretani – 1,1,1				
Trikloretani – 1,1,1	C ₂ H ₃ Cl ₃	Trikloretani – 1,1,1 (metilkloroformi)	0.1	2903.19.00
Aneksi C, grupi I; hidroklorofluorkarbonet e johalogjenuara				
Diklorofluorometani	CHFCl ₂	HCFC - 21	0.04	2903.79
Klorodifluorometani	CHF ₂ Cl	HCFC – 22	0.055	2903.71
Klorofluorometani	CH ₂ FCl	HCFC – 31	0.02	2903.79
Tetraklorofluoroetani	C ₂ HFCl ₄	HCFC – 121	0,040	2903.79
Triklorodifluoroetani	C ₂ HF ₂ Cl ₃	HCFC – 122	0,055	2903.79
Diklorotrifluoroetani	C ₂ HF ₃ Cl ₂	HCFC – 123	0,020	2903.72



Klorotetrafluoroetani	C_2HF_4Cl	HCFC – 124	0,040	2903.79
Triklorofluoroetani	$C_2H_2FCl_3$	HCFC – 131	0,080	2903.79
Diklorodifluoroetani	$C_2H_2F_2Cl_2$	HCFC – 132	0,020	2903.79
Klorotrifluoroetani	$C_2H_2F_3Cl$	HCFC – 133	0,022	2903.79
Diklorofluoroetani	$C_2H_3FCl_2$	HCFC – 141	0,050	2903.73
Diklorofluorometani	CH_3FCl_2	HCFC – 141b	0,050	2903.73
Klorodifluoroetani	$C_2H_3F_2Cl$	HCFC – 142	0,060	2903.74
Klorodifluoroetani	CH_3F_2Cl	HCFC – 142b	0,070	2903.74
Klorofluoroetani	C_2H_4FCl	HCFC – 151	0,110	2903.79
Hekzaklorofluoropropani	C_3HFCl_6	HCFC – 221	0,070	2903.79
Pentaklorodifluoropropani	$C_3HF_2Cl_5$	HCFC – 222	0,065	2903.79
Tetraklorotrifluoropropani	$C_3HF_3Cl_4$	HCFC – 223	0,005	2903.79
Triklorotetrafluoropropani	$C_3HF_4Cl_3$	HCFC – 224	0,070	2903.79
Dikloropentafluoropropani	$C_3HF_5Cl_2$	HCFC – 225	0,090	2903.75
1, 1 - d i k l o r o - 2, 2, 3, 3, 3 - pentafluoropropani	$CF_3CF_2CHCl_2$	HCFC – 225ca	0,080	2903.75
1, 3 - d i k l o r o - 1, 2, 2, 3, 3 - pentafluoropropani	CF_2ClCF_2CHClF	HCFC – 225cb	0,090	2903.75
Klorohexafluoropropani	C_3HF_6Cl	HCFC – 226	0,070	2903.79
Pentaklorofluoropropani	$C_3H_2FCl_5$	HCFC – 231	0,025	
Tetraklorodifluoropropani	$C_3H_2F_2Cl_4$	HCFC – 232	0,033	
Triklorotrifluoropropani	$C_3H_2F_3Cl_3$	HCFC – 233	0,100	
Diklorotetrafluoropropani	$C_3H_2F_4Cl_2$	HCFC – 234	0,090	
Kloropentafluoropropani	$C_3H_2F_5Cl$	HCFC – 235	0,100	
Tetraklorofluoropropani	$C_3H_3FCl_4$	HCFC – 241	0,230	
Triklorodifluoropropani	$C_3H_3F_2Cl_3$	HCFC – 242	0,280	
Diklorotrifluoropropani	$C_3H_3F_3Cl_2$	HCFC – 243	0,520	
Klorotetrafluoropropani	$C_3H_3F_4Cl$	HCFC – 244	0,090	
Triklorofluoropropani	$C_3H_4FCl_3$	HCFC – 251	0,130	
Diklorodifluoropropani	$C_3H_4F_2Cl_2$	HCFC – 252	0,120	
Klorotrifluoropropani	$C_3H_4F_3Cl$	HCFC – 253	0,140	
Diklorodifluoropropani	$C_3H_4F_2Cl_2$	HCFC – 261	0,010	
Klorotrifluoropropani	$C_3H_4F_3Cl$	HCFC – 262	0,040	
Klorofluoropropani	C_3H_5FCl	HCFC – 271	0,030	
Aneksi C, grupi II; hidrobromfluorkarbonet				
Dibromofluorometani	$CHFBr_2$	HBFC-21 B2	1,00	2903.79
Bromodifluorometani	CHF_2Br	HBFC-22 B1	0,74	
Bromofluorometani	CH_2FBr	HBFC-31 B1	0,73	
Tetrabromofluoroetani	C_2HFBr_4	HBFC-121 B4	0,8	
Tribromodifluoroetani	$C_2HF_2Br_3$	HBFC-122 B3	1,8	
Dibromotrifluoroetani	$C_2HF_3Br_2$	HBFC-123 B2	1,6	
Bromotetrafluoroetani	C_2HF_4Br	HBFC-124 B1	1,2	
Tribromofluoroetani	$C_2H_2FBr_3$	HBFC-131 B3	1,1	
Dibromodifluoroetani	$C_2H_2F_2Br_2$	HBFC-132 B2	1,5	
Bromotrifluoroetani	$C_2H_2F_3Br$	HBFC-133 B1	1,6	
Tribromofluoropropani	$C_2H_3FBr_2$	HBFC-141 B2	1,7	
Bromodifluoroetani	$C_2H_3F_2Br$	HBFC-142 B1	1,1	



Bromofluoroetani	C ₂ H ₄ FBr	HBFC-151 B1	0,1	
Hekzabromofluoropropani	C ₃ HFBr ₆	HBFC-221 B6	1,5	
Pentabromodifluoropropani	C ₃ HF ₂ Br ₅	HBFC-222 B5	1,9	
Tetrabromotrifluoropropani	C ₃ HF ₃ Br ₄	HBFC-223 B4	1,8	
Tribromotetrafluoripropani	C ₃ HF ₄ Br ₃	HBFC-224 B3	2,2	
Dibromopentafluoropropani	C ₃ HF ₅ Br ₂	HBFC-225 B2	2,0	
Bromoheksafluoropropani	C ₃ HF ₆ Br	HBFC-226 B1	3,3	
Pentabromofluoropropani	C ₃ H ₂ FBr ₅	HBFC-231 B5	1,9	
Tribromotrifluoropropani	C ₃ H ₂ F ₂ Br ₄	HBFC-232 B4	2,1	
Dibromotetrafluoripropani	C ₃ H ₂ F ₃ Br ₃	HBFC-233 B3	5,6	
Bromopentafluoropropani	C ₃ H ₂ F ₄ Br ₂	HBFC-234 B2	7,5	
Tetrabromofluoropropani	C ₃ H ₂ F ₅ Br	HBFC-235 B1	1,4	
Tribromodifluoropropani	C ₃ H ₃ FBr ₄	HBFC-241 B4	1,9	
Dibromotrifluoropropani	C ₃ H ₃ F ₂ Br ₃	HBFC-242 B3	3,1	
Bromotetrafluoropropani	C ₃ H ₃ F ₃ Br ₂	HBFC-243 B2	2,5	
Tribromofluoropropani	C ₃ H ₃ F ₄ Br	HBFC-244 B1	4,4	
Dibromodifluoropropani	C ₃ H ₄ FBr ₃	HBFC-251 B1	0,3	
Bromotrifluoropropani	C ₃ H ₄ F ₂ Br ₂	HBFC-252 B2	1,0	
Dibromofluoropropani	C ₃ H ₄ F ₃ Br	HBFC-253 B1	0,8	
Bromodifluoropropani	C ₃ H ₅ FBr ₂	HBFC-261 B2	0,4	
Bromofluoropropani	C ₃ H ₅ F ₂ Br	HBFC-262 B1	0,8	
Aneksi C, grupi III				
Bromoklorometani	CH ₂ BrCl	BCM	0,12	2903.79
Aneksi E, grupi I; bromuri i metilit				
Bromuri i metilit	CH ₃ Br		0.6	2903.39.11

Përzierjet	Kodi NK	Llojet e përzierjeve
	3824.71.00	Përzierjet që përmbajnë klorofluorkarbonë CFC, por nuk përmbajnë HCFCs HFC, PFC (aneksi A, grupi I)
	3824.72.00	Përzierjet që përmbajnë bromochlorodifluorometan, bromotrifluorometan ose dibromotetrafluoroetan
	3824.73.00	Përzierjet që përmbajnë hidrobromfluorokarbonet (aneksi C, grupi II)
	3824.74.00	Përzierjet që përmbajnë Hidroklorofluorkarbonet e halogjenuara, HCFC (aneksi C, grupi I) por nuk përmbajnë CFCs, HFC, HFC, PFC
	3824.75.00	Përzierjet që përmbajnë tetraklorur karboni (aneksi B, grupi II)
	3824.76.00	Përzierjet që përmbajnë 1,1,1-trichloroetan (metil kloroform)

SHTOJCA 2
SUBSTANCAT E REJA

Substancat		Potenciali ozonhollues (POH)
CB ₂ F ₂	Dibromodifluormetani (halon -1202)	1,25
C ₃ H ₇ Br	1-Bromopropan	0,02 – 0,10
C ₂ H ₅ Br	Bromoetan (etili i bromurit)	0,1 – 0,2
CF ₃ I	Trifluorjodometani	0,01 – 0,02
CH ₃ Cl	Klorometani (metili i kloridit)	0,02



SHTOJCA 3

PRODUKTET DHE PAJISJET QË PËRMBAJNË SUBSTANCA TË KONTROLLUARA

- **Kimikate inorganike; kimikatat organike; organike apo komponimet inorganike të metaleve të çmuara, ose metale të rralla të tokës, prej elemente radioaktive ose izotopeve**

2845 90 10

2845 90 90 90

- **Produktet farmaceutike**

3004 32 00

3004 90 00

- **Nxirëse ose ngjyrosje dhe derivatat e tyre; ngjyra, pigmente dhe lëndë të tjera ngjyruese; bojëra dhe llakë, stuko dhe mastikë të tjerë; bojëra**

3208

3209

3210

3212 90 00

- **Sapun, agjentë organikë sipërfaqësorë, preparate për larjen, preparatet lubrifikuese, dyllet artificiale, dyllet e përgatitura, përgatitjet për lustrim ose pastrim, qirinj dhe artikuj të ngjashëm, pastat e modelimit, dyllë dentare dhe preparate dentare me bazë suva**

3403 11 00

3403 91 00

- **Produkte të ndryshme kimike**

3808 91 90

3808 99 10

3808 99 90

3813 00 00

3814 00 90

3822 00 00

3824 71 00

3824 72 00

3824 73 00

3824 74 00

3824 75 00

3824 76 00

3824 77 00

3824 99 70

3825 10 00

3825 41 00

- **Plastika**

3921 11 00

3921 12 00

3921 13 10

3921 13 90

3921 14 00

3921 19 00

**- Reaktorët bërthamorë, kaldaja, makineritë dhe pajisje mekanike**

8415

8418

8419 60 00

8424 10 00

8424 90

8451 10 00

8476 21 00

8476 81 00

8476 90

8477 80 11

8477 80 19

- Lokomotiva hekurudhore ose tramvaje, mjetet lëvizëse dhe pjesët e saj; instalimet e pistave hekurudhore ose tramvajeve dhe pjesët e tyre; pajisjet mekanike (duke përfshirë elektromekanike) të sinjalizimit të trafikut të të gjitha llojeve

8601

8602

8603

8604

8605

8606

8607

8609 00 90

- Automjete të tjera, përveç mjeteve lëvizëse hekurudhore ose tramvaje, dhe pjesë dhe pajisje të tyre

8701

8702

8703

8704

8705

8708

8709

8710 00 00

8716

- Avionët dhe pjesët e tyre

8802

- Anije apo struktura lundruese

8901

8902

8903 91

8903 92

8904

8905

8906 10 00

- Impiante industriale të plota

9880 xx 00



SHTOJCA 4
DIAGRAMI I KUOTAVE VJETORE TË KONSUMIT TË HCFC-ve, EDHE NËSE GJENDEN
NË PËRZIERJE

Viti	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2030	2040
Sasia e HCFC të konsumuar Mt/vit*	98	98	98	98	98	70.8	60	55	50	45	27	23.8	0
Sasia e pakësuar e HCFC të importuar Mt/vit	0	0	0	0	0	27.2	10.8	5	5	5	18	3.2	23.8

* Në kuotën e konsumit vjetor llogariten sasitë e importuara të HCFC-ve, jo vetëm HCFC-22, por HCFC të tjera dhe gjithashtu përzierjet që përmbajnë HCFC. Për periudhën vjetore 2015–2019 do të konsumohet e njëjta kuotë, prej 98 metrikë tonë në vit. Për periudhën vjetore 2025–2030 do të ulet me 2% në vit deri në kuotën 23,8 tonë. Mbas vitit 2030 parashikohet eliminimi i HCFC-së, duke lejuar një mesatare vjetore importi prej 2.5% për serviset për periudhën 2031–2039.

SHTOJCA 5
PËRDORIME LABORATORIKE DHE
ANALITIKE TË SUBSTANCave TË
KONTROLLUARA

1. Përdorimet e mëposhtme të substancave të kontrolluara, përveç hidroklorofluorokarboneve, konsiderohen si përdorime thelbësore laboratorike dhe analitike:

a) përdorimi i substancave të kontrolluara, si një referencë apo standard:

- për të kalibruar pajisje që përdorin substanca të kontrolluara,
- për të monitoruar nivelet e emetimit të substancave të kontrolluara,
- për të përcaktuar nivelin e mbetjeve të substancave të kontrolluara në mallra, bimë dhe produkte.

b) përdorimi i substancave të kontrolluara në studimet laboratorike toksikologjike;

c) përdorimi laboratorik në të cilin substancat e kontrolluara shndërrohen në një reaksion kimik si substanca të kontrolluara që përdoren si *feedstock*;

ç) përdorimi i metilit të bromurit në një

laborator për të krahasuar efikasitetin e metilit të bromurit dhe alternativat e tij;

d) përdorimi i tetraklurit të karbonit si një tretës për reagimet e bromizimit që përfshijnë N-bromosuccineimidet;

dh) përdorimi i tetraklurit të karbonit si agjent transferimi zinxhir në reaksionet e lira radikale të polimerizimit;

e) çdo përdorim tjetër laboratorik dhe analitik për të cilët nuk ka një alternativë tjetër të mundshme teknikisht dhe ekonomikisht.

2. Përdorimet e mëposhtme të të gjitha substancave të kontrolluara të tjera, përveç hidroklorofluorokarboneve, nuk konsiderohen si përdorime thelbësore laboratorike dhe analitike:

a) pajisjet e përdorura në laborator për ngrirje dhe ajër të kondicionuar, duke përfshirë pajisjet frigoriferike laboratorike të tilla si *ultracentrifuga*;

b) pastrimi, ripunimi, riparimi, apo rindërtimi i komponentëve elektronikë;

c) ruajtja e publikimeve dhe arkivave;

ç) sterilizimi i materialeve në një laborator;

d) çdo përdorim në arsim fillor ose të mesëm;

dh) si komponentë në sete eksperimentale kimie, në dispozicion për publikun e gjerë dhe jo të destinuara për përdorim në arsimin e lartë;

e) për qëllime pastrimi apo tharje, duke përfshirë heqjen e yndyrave nga qelqet dhe nga pajisje të tjera;

ë) për përcaktimin e hidrokarbureve, vajrave dhe yndyrave në ujë, tokë, ajër ose mbetje;

f) testimi i katranit në materialet për shtrimin e rrugëve;

g) për qëllime ligjore të marrjes së shenjave



të gishtërinjve;

gj) testimi i lëndës organike në qymyr;

h) si një tretës në përcaktimin e cyanocobalamin (vitaminë B12) dhe bromur indeksi;

i) në metodat që përdorin tretjen selektive në substancat e kontrolluara përfshirë përcaktimin e cascarosides, ekstrakteve tiroide, dhe formimin e pikrates;

j) për tejperqendrimin e substancave kimike që do t'u nënshtrohen metodave kromatografike (për shembull kromatografi likuide e performancës së lartë (HPCL), kromatografi gazrash, (GC), kromatografi absorbuese, spektroskopi absorbuese atomike (AAS), spektroskopi plazmore (ICP), analizë fluoreshente me rreze X (*x-ray*);

k) për përcaktimin e indeksit të jodit në yndyrna dhe vajra;

l) ndonjë përdorim tjetër laboratorik dhe analitik, për të cilin ka një alternativë tjetër

teknikisht dhe ekonomikisht të mundshme.

SHTOJCA 6

PËRDORIMET THELBËSORE TË HALONIT

Në kuptim të kësaj shtojce, do të zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

“Hapësirë normalisht e populluar”, një hapësirë e mbrojtur në të cilën është e nevojshme prezenca e njerëzve, në shumicën e kohës ose gjatë gjithë kohës, në mënyrë që pajisjet apo objektet të funksionojë siç duhet.

“Hapësirë normalisht jo e populluar”, një hapësirë e mbrojtur që është e populluar vetëm në periudha të kufizuara, veçanërisht gjatë mirëmbajtjes, dhe ku prania e vazhdueshme e njerëzve nuk është e nevojshme për funksionimin efektiv të pajisjeve ose të objektit.

Kategoria e pajisjes ose objektit	Qëllimi i përdorimit	Lloji i halonit
1. Në automjetet tokësore ushtarake	1.1 Për mbrojtjen e pjesëve të motorit	1301 1211 2402
	1.2 Për mbrojtjen e kabinës së ekuipazhit - sistem fiks	1301 2402
	1.3 Për mbrojtjen e kabinës së ekuipazhit - aparat portativ	1301 1211
2. Në anijet ushtarake në sipërfaqe	2.1 Për mbrojtjen e hapësirave të makinerive normalisht të populluara	1301 2402
	2.2 Për mbrojtjen e hapësirave të motorëve normalisht jo të populluara	1301 1211 2402
	2.3 Për mbrojtjen e ndarjeve elektrike normalisht jo të populluara	1301 1211
	2.4 Për mbrojtjen e qendrave të komandos	1301
	2.5 Për mbrojtjen e dhomave të pompave të karburantit	1301
	2.6 Për mbrojtjen e magazinave të lëngjeve të djegshme	1301 1211 2402
	2.7 Për mbrojtjen e avionëve në hangar dhe zonave të mirëmbajtjes	1301 1211
3. Në nëndetëset ushtarake	3.1 Për mbrojtjen e hapësirave të makinerive	1301
	3.2 Për mbrojtjen e qendrave të komandos	1301
	3.3 Për mbrojtjen e hapësirave ku mbahen gjeneratorët me naftë	1301
	3.4 Për mbrojtjen e dhomave/ndarjeve elektrike	1301
4. Në avionë	4.1 Për mbrojtjen e hapësirave normalisht jo të populluara ku mbahen ngarkesa/ mallra	1301 1211



		2402
	4.2 Për mbrojtjen e kabinës së ekuipazhit	1211
		2402
	4.3 Për mbrojtjen e kabinës së hapur të motorit dhe njësive ndihmëse të energjisë	1301
		1211
		2402
	4.4 Për të bërë cisternat e naftës inerte	1301
		2402
	4.5 Për mbrojtjen e mbledhëses së mbetjeve të tualetit	1301
		1211
		2402
	4.6 Për mbrojtjen e ndarjeve ngjitur me cisternat e karburantit ose lëngjeve të tjera të ndezshme	1301
		1211
		2402
5. Në pajisje nafte, gazi dhe petrokimike	5.1 Për mbrojtjen e hapësirave ku mund të lëshohet lëng ose gaz i djegshëm	1301
		2402
6. Në anije mallrash tregtare	6.1 Për të bërë inerte hapësira normalisht të populluara ku mund të lëshohet lëng ose gaz i djegshëm	1301
		2402
7. Në vendshërbimet e komandove të brendshme dhe komunikimeve thelbësore për sigurinë shtetërore	7.1 Për mbrojtjen e hapësirave normalisht të populluara – me sistem fiks	1301
		2402
	7.2 Për mbrojtjen e hapësirave normalisht të populluara – me aparat portativ	1211
	7.3 Për mbrojtjen e hapësirave normalisht jo të populluara	1301
		2402
8. Në aerodrome dhe aeroporte	8.1 Për automjetet shpëtuese pas shpërthimit–aparat portativ	1211
	8.2 Për mbrojtjen e avionëve në hangar dhe zonave të mirëmbajtjes – aparat portativ	1211
9. Të tjera	9.1 Për shuarjen fillestare të zjarrit nga skuadra e zjarrfikëses, e nevojshme për sigurinë personale – aparat portativ	1211
	9.2 Për mbrojtjen e individëve nga ushtria dhe policia – aparat portativ	1211

SHTOJCA 7 TEKNOLOGJITË E MIRATUARA TË SHKATËRRIMIT¹

Lloji i teknologjisë	Substanca të kontrolluara ²		Burime të holluara ³
	SK e grupeve I, II, IV, V dhe VII	Halonet në grupin 3	Shkumat
Efikasiteti i shkatërrimit dhe asgjësimit	99,99 %	99,99%	95 %
Furrë çimentoje	Miratur ⁴	Nuk është miratur	Nuk është e aplikueshme
Djegje me injeksion të lëngshëm	Miratur	Miratur	Nuk është e aplikueshme
Oksidim i gaztë / me tym	Miratur	Miratur	Nuk është e aplikueshme
Djegja e mbetjeve të ngurta urbane	Nuk është e aplikueshme	Nuk është e aplikueshme	Miratur

² Substancat e kontrolluara që nuk janë të listuara këtu, do të shkatërrohen nga teknologji shkatërrimi, që konsiderohen më të pranueshme për mjedisin nuk sjellin shpenzime të tepërta. Substancat në këtë kategori i referohen substancave të kontrolluara të virgjëra, të rikuperuara dhe të riaftësuar.

³ Burimet e holluara i referohen substancave të kontrolluara të përfshira në matricën e një sendi të ngurtë, për shembull në shkumë.

⁴ Miratur do të nënkuptojë “e miratur nga Palët”.



Plasartitje me reaktor	Miratuar	Nuk është miratuar	Nuk është e aplikueshme
Djegje me furrë rrotulluese	Miratuar	Miratuar	Miratuar
Shkrirje me plazmë argoni	Miratuar	Miratuar	Nuk është e aplikueshme
Plazmë e frekuencave të radiove	Miratuar	Miratuar	Nuk është e aplikueshme
Plazmë mikrovalë	Miratuar	Nuk është miratuar	Nuk është e aplikueshme
Plazmë nitrogjeni	Miratuar	Nuk është miratuar	Nuk është e aplikueshme
Dehalogjenimi katalitik me fazë gazi	Miratuar	Nuk është miratuar	Nuk është e aplikueshme
Reaktor me avull të tejnxehur	Miratuar	Nuk është miratuar	Nuk është e aplikueshme

SHTOJCA 8

FORMULARI I NJOFTIMIT TË IMPORTIT
TË SUBSTANCËVE TË KONTROLLUARA

1. Emri dhe të dhënat e sipërmarrësit të licencuar:

2. Numri i licencës:

3. Nr. telefoni:

4. Emri dhe kodi tarifor për substancën ozonholluese që do të importohet:

5. Emri dhe kodi tarifor për produktin që përmban ose përdor substancën ozonholluese që do të importohet:

6. Formula kimike për substancën ozonholluese që do të importohet ose që përmbahet në produktin që do të importohet:

7. Sasia në kilogramë e substancës ozonholluese që do të importohet:

8. Sasia në kilogramë e substancës ozonholluese që përmbahet në njësinë e produktit që do të importohet:

9. Emri i shoqërisë tregtare nga do të blihet substanca ozonholluese dhe të dhënat e saj:

10. Adresa (shteti, qyteti, rruga, nr. etj.):

11. Telefoni:

12. Fax:

13. Qëllimi i përdorimit të substancës ozonholluese:

14. Data e njoftimit:

Personi i autorizuar
Emër mbiemër
(firma, vula)

SHTOJCA 9

TË DHËNAT PËR TË RAPORTUAR NË
PËRPUTHJE ME KREUN XI

1. Çdo prodhues referuar kreut XI, duhet të raportojë për:

a) sasinë totale të çdo substance të listuar në shtojcat 1 dhe 2, që ai ka prodhuar në Republikën e Shqipërisë, identifikimin kategorive kryesore të përdorimit në të cilën substance

përdoret;

b) sasinë e çdo substance të listuar në shtojcat dhe kur është e zbatueshme, në shtojcën 1, kur është e zbatueshme në shtojcën 2 që ka vendosur në tregun e Republikës së Shqipërisë, duke specifikuar në mënyrë të ndarë sasinë e vendosura në treg për përdorime të *feedstock*, eksportet e drejtpërdrejta, duke prodhuar doza të matura të inhalatorëve për shpërndarjen e përbërësve farmaceutikë, përdorimit në pajisjeve ushtarake dhe përdorimit në gravurën e materialit gjysmëpërçues apo pastrimin me avull kimik brenda sektorit të prodhimit gjysmëpërçues;

c) sasinë e çdo substance të listuar në shtojcat të cilat janë ricikluar, rigjeneruar dhe shkatërruar, respektivisht;

ç) çdo rezervë të mbajtur në fillim dhe në fund të periudhës së raportimit.

2. Çdo importues referuar kreut X, duhet të raportojë, për:

a) sasinë e çdo substance të listuar në shtojcën 1 dhe kur është e zbatueshme në shtojcën 2, që ka importuar në Republikën e Shqipërisë, identifikimin e kategorive kryesore të përdorimit në të cilën substanca përdoret duke specifikuar në mënyrë të ndarë sasinë e vendosura në treg për shkatërrim, për përdorim *feedstock* eksportet e drejtpërdrejta, duke prodhuar doza të matura të inhalatorëve për shpërndarjen e përbërësve farmaceutikë, përdorimit në pajisje ushtarake dhe përdorimit në gravurën e materialit gjysmëpërçues apo pastrimin me avull kimik brenda sektorit të prodhimit gjysmëpërçues;

b) sasinë e çdo substance të listuar në shtojcat 1 dhe 2, të cilat janë ricikluar, rigjeneruar dhe shkatërruar respektivisht;

c) çdo rezervë të mbajtur në fillim dhe në fund të periudhës së raportimit.

3. Çdo eksportues, referuar kreut XII, duhet të raportojë, për:

a) sasinë e çdo substance të listuar në shtojcat 1 dhe 2, që ka eksportuar nga Republika e



Shqipërisë, përveç riciklimit, rigjenerimit ose shkatërrimit;

b) çdo sasi të e çdo substancë të listuar në shtojcat 1 dhe 2, që ka eksportuar nga Republika e Shqipërisë për t'u ricikluar, rigjeneruar dhe shkatërruar, respektivisht.

4. Çdo sipërmarrje e përmendur në kreun XII do të raportojë, për:

a) sasitë e çdo substance të listuar në shtojcat 1 dhe 2 të shkatërruar, duke përfshirë edhe sasinë e atyre substancave që gjenden në produkte ose pajisje;

b) çdo rezervë e çdo substance të listuar në shtojcat 1 dhe 2, në pritje për t'u shkatërruar; duke përfshirë edhe sasinë e atyre substancave që gjenden në produkte ose pajisje;

c) teknologjitë e përdorur për shkatërrimin e substancave të listuara në shtojcat 1 dhe 2.

5. Çdo sipërmarrje e përmendur në kreun XI, duhet të raportojë për sasitë e çdo substance të listuar në shtojcën 1, të përdorur si *feedstock*:

6. Çdo sipërmarrje e përmendur në kreun XI, duhet të raportojë, për:

a) kategorinë e produkteve ose të pajisjeve që përmbajnë substance të listuara në shtojcat 1 dhe 2;

b) numrin e njësisë;

c) çdo sasi të çdo substance të listuar në shtojcat 1 dhe 2, të përfshira në produkte ose pajisje.

VENDIM

Nr. 11, datë 9.1.2019

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2019 PËR DREJTORINË E SHËRBIMEVE QEVERITARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 99/2018, "Për buxhetin e vitit 2019", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, në buxhetin e vitit 2019, në zërin "Shërbime qeveritare", i shtohet fondi prej 66 972 800

(gjashtëdhjetë e gjashtë milionë e nëntëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e tetëqind) lekësh, brenda datës 31 janar 2019, për organizimin e Samitit të Dytë të Diasporës, që do të zhvillohet në datat 28 shkurt – 2 mars 2019 në Tiranë dhe Lezhë.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2019.

3. Ministria e Kulturës, brenda fushës së përgjegjësisë së vet, të bashkërendojë me Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare për organizimin e aktiviteteve social-kulturore dhe vendosjen në përdorim të monumenteve të kulturës, sipas rastit.

4. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Kulturës, ministri i Shtetit për Diasporën dhe Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 13, datë 14.1.2019

PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN NË DETYRË TË PREFEKTIT TË QARKUT TË ELBASANIT

Në mbështetje të neneve 100 e 114, të Kushtetutës, dhe të nenit 5, të ligjit nr. 107/2016, "Për prefektin e qarkut", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Maksim Malaj, prefekt i qarkut të Elbasanit, lirohet nga kjo detyrë.

2. Z. Gledian Llatja emërohet prefekt i qarkut të Elbasanit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 280 lekë